



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT TË NDËRMARRJES PUBLIKE
“TELEKOMI I KOSOVËS “**

PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

Prishtinë, Qershor 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të NP Telekomit i Kosovës Sh.A., në konsultim me Ndhmës Auditoren e Përgjithshme Arvita Zyferi, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësi i ekipit të auditimit financiar Jusuf Kryeziu dhe anëtarëve të ekipit Alban Shatri, Naim Neziri, Aida Podrimaj, dhe nga Udhëheqësi i ekipit të auditimit për pjesën e Teknologjisë Informative Arbërore Sheremeti dhe anëtarëve të ekipit Shqipe Mujku Hajrizi dhe Shqipe Azemi nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Fitim Haliti.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	14
4 Qeverisja e mirë.....	30
5 Sistemet informative.....	37
6 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	51
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	62
Shtojca II: Letër konfirmimi.....	65
Shtojca III: Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit.....	66

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Ndërmarrjes Publike Telekomit të Kosovës Sh.a për vitin 2018, i cili përfshinë Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 24.12.2018

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Telekomit të Kosovës Sh.a.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i Kundërt

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018, nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale.

Për më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Përgatitja e pasqyrave financiare në një formë e cila nuk është e përshtatshme dhe nuk pasqyron realitetin ekonomik të Telekomit ka ndikuar në modifikimin e opinionit për vitin 2018.



Kryesuesi i Bordit duhet t'i analizojë arsyet për modifikim të Opinionit për PFV-të e vitit 2018 dhe t'i identifikojë veprimet që kërkohen për të mundësuar një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të PFV-ve në vitin 2019 (shih çështjet tek baza për opinion).

Edhe pse në disa fusha kontrollet e brendshme janë efektive - ekzistojnë dobësi në fushën e menaxhimit të pasurive, menaxhimit të personelit dhe realizimit të shpenzimeve



Kryesuesi i Bordit duhet ta aplikojë një vlerësim të detajuar të dobësive në fushën e pasurive dhe fushave tjera brengosëse të theksuara në këtë raport për t'i identifikuar arsyet për paraqitjen e dobësive si dhe veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih çështjet A1 deri A11 si dhe B1 dhe B2).

Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me kontrollet e brendshme përfshirë menaxhimin e rrezikut dhe fushën e auditimit të brendshëm janë përcjellë me mangësi.



Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë marrë masa konkrete për të përmirësuar aktivitetet që ndikojnë në forcimin e kontrolleve të brendshme. (shih çështjet A12 deri A17).

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Kryesuesi i Bordit është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, përveç çështjes që ndërlidhet me mos krahasimin ndërmjet trafikut të regjistruar në SWITCH-at e rrjetit qendror dhe sistemeve të faturimit. Komenti i Kryesuesit të Bordit për çështjen që nuk është pajtuar, është dhënë në detaje në Shtojcën III.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Telekomit të Kosovës gjatë procesit të auditimit.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase.
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Telekomit të Kosovës Sh.a, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, testet e pajtueshmërisë si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën III.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë të përgatitura dhe nënshkruara nga Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit (ZKFTH) dhe Kryeshefi Ekzekutiv (KE) dhe dorëzohen për miratim në Bordin e Drejtorëve (BD).

Miratimi i PFV-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë aksionarit dhe publikut të gjerë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i kundërt

Kemi audituar PFV-të e Telekomit të Kosovës Sh.a për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse, pasqyrën e rrjedhjes së parasë, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet si dhe përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, për shkak efekteve dhe të mungesës së informacioneve/çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kundërt, pasqyrat vjetore financiare nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, të Telekomit të Kosovës Sh.a për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligjet e Kosovës. Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit aktual të kontabilitetit, Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime).

Baza për opinion të kundërt

Çështjet më poshtë tregojnë që ekzistojnë pasiguri materiale të cilat, individualisht ose kolektivisht mund të shkaktojnë dyshime të rëndësishme për aftësinë e Kompanisë për të vazhduar në vijimësi dhe rrjedhimisht ajo mund të mos jetë në gjendje të realizojë aktivet e saj dhe të shlyejë detyrimet gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë. Pasqyrat financiare (dhe shënimet anekse përkatëse) nuk e paraqesin këtë fakt.

1. Në vitin 2009, Telekom i Kosovës Sh.a kishte lidhur marrëveshje partneriteti/mbështetje me Operatorin e Rrjetit Mobil Virtual (ORMV) Dardafon.net l.l.c, në të cilën marrëveshje janë përcaktuar bazat e bashkëpunimit në mes palëve.

Në vitin 2016 ORMV kishte ngritur padi kundër Telekomit të Kosovës Sh.a në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit (GJNA), për mosrespektim të marrëveshjes bazë. Në vendimin përfundimtar (ICC Case No 20990/MHM, datë 19.06.2016) GJNA ndër të tjera obligoi Telekomin e Kosovës Sh.a të paguaj dëmshpërblim ndaj ORMV në vlerë prej 31,178,920 €.

Në bazë të situatës së krijuar, ORMV dhe Telekom i Kosovës Sh.a kanë lidhur Marrëveshjen për Ekzekutim të Vendimit të Arbitrazhit dt. 24.05.2017 e cila marrëveshje ndër të tjera parasheh që Telekom i Kosovës të heqë dorë nga inkasimi i të hyrave nga ORMV (27% e të hyrave të ORMV në bazë të aneksit 2 të marrëveshjes bazë) deri me 31.12.2023, ndërsa ORMV heqë dorë nga procedura e njohjes dhe ekzekutimit të vendimit të GJNA, duke tërhequr propozimin për njohje të dt. 07.03.2017.

Me datë 26.04.2018 ORMV përmes një shkrese zyrtare ka dërguar njoftim në Telekom për shkëputje të Marrëveshjes për Ekzekutim të Vendimit të Arbitrazhit. Më pas, Dardafon kishte iniciuar procedurën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë. Me datë 11.02.2019 Gjykata Themelore në Prishtinë ka njohur dhe ka shpallur të ekzekutueshëm vendimin e GJNA. Po ashtu, vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr 88/2019 dt.01.04.2019 ka hedhur poshtë ankesën e Telekomit të Kosovës Sh.a kundrejt vendimit të Gjykatës Themelore. Telekom i Kosovës tutje ka dorëzuar një propozim për mbrojtje të ligjshmërisë në Prokurorinë e Shtetit me dt. 15.04.2019. Megjithatë, sipas interpretimit të Zyrës Ligjore të Telekomit të Kosovës iniciimi i propozimit për mbrojtje të ligjshmërisë tek Prokurori i Shtetit është mjet i jashtëzakonshëm juridik dhe nuk e pengon/ndal ekzekutimin e vendimit të GJNA. Deri në datën në të cilën ORMV është tërhequr nga Marrëveshja për Ekzekutim të Vendimit të Arbitrazhit (26.04.2018), borxhi i reduktuar/i mbetur nga dorëheqja e Telekomit të Kosovës për të inkasuar 27% e të hyrave nga ORMV është 23,297,463€ i cili borxh mund të jetë edhe më i madh pasi që të bëhet përlllogaritja e interesit dhe ndëshkimet tjera të përcaktuara. Një përlllogaritje e tillë për kamatat dhe ndëshkimet nuk është bërë ende nga ana e Telekomit të Kosovës Sh.a.

Ne kemi kryer procedurat e auditimit në kontekstin e vlerësimit të përshtatshmërisë së hipotezës së vijimësisë sipas udhëzimeve të Standardit Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 570 dhe kemi konstatuar që nuk janë bërë shpalosjet e duhura në pasqyrën e shënimeve shpjeguese pasi që është deklaruar se: "Me këtë marrëveshje (Marrëveshja për Ekzekutim të Vendimit të Arbitrazhit) është arritur pezullimi i zbatimit të menjëhershëm të vendimit të GJNA duke u mundësuar palëve që të vazhdojnë bashkëpunimin komercial në harmoni me dispozitat obligative të kontratës në fuqi dhe kërkesave të vendimit të GJNA". Në fakt ORMV është tërhequr nga marrëveshja me dt.26.04.2018 dhe tani siç shpjegohet më lartë, vendimi i GJNA është i ekzekutueshëm.

Ne po ashtu sipas udhëzimeve të SNA 570 kemi vlerësuar edhe planet e menaxhmentit për të ardhmen që ndërlidhen me hipotezën e vijimësisë, përkatësisht Strategjinë për dalje nga gjendja emergjente e miratuar nga Bordi Drejtorëve të kompanisë 07.06.2018. Në këtë dokument masa nr.6 parasheh shqyrtimin e kontratës dhe borxhit ndaj ORMV Dardafon. Për këtë qëllim Bordi i

Drejtorëve dt. 29.06.2018 ka autorizuar Kryeshefin Ekzekutiv që të përgatis një raport mbi aspektin ekonomik të kontratës me (ORMV) Dardafon.net l.l.c përkatësisht "Vlerësimet përfundimtare nëse marrëveshja për Mbështetje e datës 16.01.2009 është ekonomikisht e favorshme për TK-në, dhe nëse jo, cilat janë kushtet minimale ekonomike për tu konsideruar e favorshme për TK-në". Kryeshefi ka autorizuar një komision të brendshëm për të bërë këto vlerësime. Ky komision në raportin dt. 10.08.2018 kishte nxjerrë disa përfundime rreth çështjes së ngritur nga Bordi. Ndër të tjera, komisioni kishte ardhur në përfundim se një vlerësim i tillë nuk mund të bëhet nga vet komisioni dhe se kjo detyrë duhet t'i delegohet Komisionit të Auditimit. Më tutje, komisioni i auditimit kishte sugjeruar që të angazhohet ekspertizë e jashtme nga ndonjë institucion me renome botërore që të jap konstatimin rreth faktit nëse MSA (Marrëveshja bazë) është ekonomikisht e favorshme ose jo për TK-në. Aktualisht Telekom i Kosovës Sh.a është në proces të negociatave me (ORMV) Dardafon.net l.l.c lidhur me kushtet e vazhdimit të bashkëpunimit komercial (pas dt.30 Korriku 2019) edhe përkundër faktit që nuk është bërë një analizë mbi arsyeshmërinë ekonomike për vazhdimin ose mos vazhdimin e një kontrate të tillë. Ndërkohë që në raportin e komisionit të sipërpërmendur, nuk është dhënë ndonjë zgjidhje konkrete se si duhet veprohet nëse vije deri te ekzekutimi i vendimit të GJNA (pagesa e borxhit ndaj ORMV). Ajo që është shprehur në këtë raport është se "inicimi i ekzekutimit me përmbarrim të vendimit final të arbitrazhit dhe ekzekutimi me përmbarrim do të përfundojë sigurisht me bllokim total të korporatës".

Në këtë kontekst është analizuar edhe Projektioni i rrjedhës së parasë për vitin 2019, dhe kemi vërejtur që ky projektion nuk parasheh pagesën e këtij borxhi. Në një situatë të tillë, nëse kreditori ORMV fillon procedurat e përmbarrimit, ekziston pasiguri materiale që mundë të hedhë dyshime të konsiderueshme në aftësinë e Telekomit të Kosovës Sh.a për të vazhduar aktivitetet sipas parimit të vijimësisë.

2. Aktiviteti kryesor i biznesit të Telekomit të Kosovës Sh.a është i mbështetur në teknologji informative. Duke ju referuar raportit të përgatitur nga Departamenti Teknik i TK-së sipas kërkesës tonë ZKA (16.04.2018), gjendja e sistemeve dhe platformave të teknologjisë të cilat mundësojnë ofrimin e shërbimeve telekomunikuese është e rëndë. Kjo gjendje e rëndë për disa platforma është qysh para vitit 2010 (për sistemet transmetuese -telefonja fikse) ndërsa në rrjetin mobil që nga viti 2016 kur janë bërë instalimet e fundit në rrjet. Më pas, kjo gjendje në mënyrë progresive ka ardhur duke u keqësuar si rezultat i daljes nga garancioni i pajisjeve, konsumi i pjesëve rezervë në stok si dhe amortizimi i pajisjeve. Për shumicën e platformave dhe sistemeve cilat mundësojnë ofrimin e shërbimeve telekomunikuese mirëmbajtja kryhet vetëm nga stafi teknik i TK-së. Për shumicën e sistemeve (rrjeti fiks, mobil, IPTV dhe ISP) nuk ka kontrata aktive të mirëmbajtjes/përkrahjes teknike nga prodhuesi. Ky raport ka renditur rreziqet e mundshme si rezultat i gjendjes aktuale dhe mungesës së investimeve dhe kontratave të mirëmbajtjes:

- Ndërprerje e plotë e të gjitha shërbimeve që afekton të gjithë konsumatorët në rrjet (Vala, Operatori mobil virtual, Romer);
- Ndërprerje e pjesshme e shërbimit në zona të caktuara të mbulimit;
- Kohëzgjatje e madhe e zgjidhjes së problemit/defektit;
- Pamundësi e neutralizimit të problemit; dhe

- Pamundësi e riparimit të pajisjeve me defekt.

Po ashtu, ky raport liston edhe dy projekte të rëndësishme që dalin si obligim ligjor (Projekti i migrimit në kodin e ri shtetëror të Kosovës deri me 1 janar 2019, si dhe projekti i implementimit të infrastrukturës për Përgjime Ligjore) që në rast të mos implementimit të tyre TK mund të ketë implikime ligjore.

Sipas udhëzimeve të SNA 570 ne kemi vlerësuar planet e ardhshme të menaxhmentit që adresojnë këtë çështje, përkatësisht Strategjinë për dalje nga gjendja emergjente e miratuar nga Bordi i Drejtorëve të kompanisë. Adresimi i kësaj çështje është synuar të arrihet përmes sigurimit të një financimi në shumën 30,000,000€ për implementimin e investimeve kapitale emergjente që do të shpëtojnë TK nga një kolaps teknik dhe operativ siç thuhet në këtë dokument. Në këtë kontekst, aktualisht ekziston vetëm një shkresë drejtuar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE) (aksionarit) në të cilën kërkohet nga MZHE të jetë garantues i një kredie në vlerë 11,217,230€ që TK synon ta marrë në bankat komerciale për të realizuar disa nga investimet emergjente. Kjo shkresë është drejtuar me datë 07.02.2019, mirëpo ende nuk kanë marrë përgjigje. Autorizimi i një garancie të tillë (nëse miratohet nga MZHE) sipas Ligjit për Borxhin Publik Nr. 03/L-175, neni 19.2 do t'i nënshtrohet miratimit me dy të tretat (2/3) e votave të gjithë deputetëve të Kuvendit. Ne kemi analizuar projeksionin e rrjedhës së parasë 2019, dhe kemi vërejtur që nuk ekzistojnë mbështetje adekuate të parashikimeve në këtë plan. Ky plan parashih investime kapitale në vlerë prej 25,000,000€ megjithatë ne vlerësojmë se aktualisht menaxhmenti nuk ka alternativa realiste për sigurimin e financimit shtesë të planifikuar po ashtu në vlerë 25,000,000€. Kjo situatë gjithashtu hedhë dyshime të konsiderueshme në aftësinë e kompanisë për të vazhduar sipas hipotezës së vijimësisë.

3. Në fundin e muajit korrik 2019 skadon licenca e TK-së për brezin e frekuencave në ARKEP. Në bazë të vendimit të ARKEP Nr. 1388 Nr.Prot. 056/B/19, sipas metodologjisë "on off fee" për 15 vite, kostoja për brezat ekzistuese të TK do të jetë 11,411,521€, përkatësisht 1800MHz 2x25MHz =6,339,734€ dhe 900MHz 2x10MHz=5,071,787€. Në projeksionin e rrjedhës së parasë 2019 është paraparë që shuma totale e marrjes së kësaj licence të jetë 15,000,000€ e ndarë në këste për 15 vite, që do të thotë për vitin 2019 janë paraparë 1,000,000€. Sipas dokumentit në fjalë ARKEP njofton operatorët se do të shqyrtojë mundësinë e realizimit të pagesës me këste, dhe aktualisht janë në procedurë të pranimit të komenteve dhe arsyetimet e operatorëve lidhur me këtë çështje. Megjithatë, ende nuk ka një vendim final nga ana e ARKEP lidhur me kushtet e pagesës, përkatësisht lidhur me lartësinë e kësteve si dhe afatet e pagesës.

4. Telekomit ka vazhduar trendin e operimit me humbje, përkatësisht në vitin 2015 humbja totale që i atribuohet pronarëve/aksionarit në Pasqyrën e të ardhurave (PA) ishte 7,904,000 €, në vitin 2016 humbja ishte 50,931,000 €, në vitin 2017 humbja ishte 13,904,000 €, dhe në vitin 2018 humbja e paraqitur në Pasqyrën e Fitimit ose Humbjes për Periudhën ishte 15,575,000€. Kapitali aksionar i emetuar si dhe komponentët tjerë të kapitalit në vlerën 59,475,000€ është zvogëluar nga humbjet e akumuluar në vlerë 34,022,000€ që do të thotë se vlera e mbetur e ekuitetit është 25,453,000€. Rezultatet e tilla nuk reflektojnë dividendën e deklaruar në vitin 2015 në vlerë prej 15,000,000€ e cila ende nuk është paguar. Prandaj nëse vazhdon trendi i tillë vlera e ekuitetit mund të bie në zero. Kjo

situatë gjithashtu hedhë dyshime të konsiderueshme në aftësinë e Kompanisë për të vazhduar sipas hipotezës së vijimësisë.

5. Koeficientët kyç financiar të përlogaritur në shifrat e PFV-e 2018 janë të pa favorshëm/negativ:

- Likuiditeti i rrjedhës = 0,34 matë aftësinë e kompanisë për të paguar detyrimet e saj aktuale (të pagueshme brenda një viti) me aktivet e saj të tanishme si para të gatshme, llogaritë e arkëtueshme dhe inventarët. Koeficienti i dëshirueshëm/i pranueshëm varion nga 1,5 deri në 2. Likuiditeti i rrjedhës më i vogël se 1 është tregues që kompania mund të ketë probleme serioze në përmbushjen e detyrimeve të saj afatshkurta.
- Likuiditeti i Shpejtë (Testi ACID) = 0.19 matë aftësinë e një kompanie për të përmbushur detyrimet e saj afatshkurtra me aktivet më likuide dhe për këtë arsye përjashton inventarët nga aktivet e saj të tanishme. Testi acid më i vogël se 1 tregon po ashtu që kompania mund të ketë probleme serioze në përmbushjen e detyrimeve të saj afatshkurta.
- Neto kapitali punues -0.46, përfaqëson pasuritë qarkulluese të disponueshme për të paguar detyrimet afatshkurtra dhe gjithashtu të investojë në aktivitetet që gjenerojnë të ardhura. Kapitali i punës negativ është kur detyrimet rrjedhëse të kompanisë tejkalojnë pasuritë e saj aktuale. Kjo do të thotë se detyrimet që duhet të paguhet brenda një viti tejkalojnë pasuritë aktuale që janë lehtë të shndërrueshme në para të gatshme për të njëjtën periudhë. Raporti optimal i pranueshëm është midis 1.2 dhe 2.
- Qarkullimi i llogarive të arkëtueshme është 51.83, që tregon se brenda vitit llogaritë e arkëtueshme qarkullojnë 51.83 herë ose afërsisht për dy muaj. Qarkullimi i llogarive të arkëtueshme është numri i herëve në vit që kompania mbledh llogaritë mesatare të arkëtueshme. Raporti është përdorur për të vlerësuar aftësinë e kompanisë për të shitur me kredi në mënyrë efikase për klientët e saj dhe për të mbledhur fonde prej tyre në kohën e duhur. Në parim, një raport i ulët i xhiros nënkupton që kompania duhet të rivlerësojë politikat e saj të shitjes me kredi për të siguruar mbledhjen me kohë të të arkëtueshmeve të saj.
- Raporti i Borxhit 0.69, nënkupton që pjesëmarrja e detyrimeve në pasuri është rreth 70%. Raporti i borxhit përkufizohet si raporti i borxhit total ndaj totalit të aktiveve, shprehur në përqindje. Raporti më i madh se 0.5 apo 50%, shumica e aseteve të kompanisë financohet përmes borxhit. Sa më i lartë të jetë ky raport aq më i lartë është rreziku i funksionimit/operimit të kompanisë. Përveç kësaj, raporti i borxhit të lartë ndaj aktiveve mund të tregojë një kapacitet të ulët të kompanisë për huamarrje, e cila nga ana tjetër do të ulë fleksibilitetin financiar të kompanisë.

Auditimi jonë është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore dhe NP-ve në Kosovë, ZKA është e pavarur nga Kompania Telekomit i Kosovës Sh.a dhe përgjegjësitë

tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë të kundërt.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në bazë të parimit akrual sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime) dhe Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Kryesuesi i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ndërmarrjes.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

NP kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare;
- Kërkesat e Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiare dhe Auditim;
- Kërkesat e Ligjit nr. 04/L- 42 për Prokurimin Publik (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Udhëzimit nr. 2/2013/MF për Strukturën dhe Përbajtjen e Raporteve Financiare Vjetore; dhe
- Nga NP-të, po ashtu kërkohet të përmbush edhe kërkesat si në vijim:
 - Statutin e NP-së;
 - Planin e Biznesit;
 - Raportet tremujore;
 - Raportin vjetor;
 - Raportin nga matja e kënaqshmërisë së Konsumatorëve; dhe
 - Draft planin dhe planin përfundimtar të prokurimit me kohë.

2.3 Rekomandimi lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi A1 ¹Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një analizë e detajuar për t'i përcaktuar shkaqet të cilat kanë ndikuar në modifikim të Opinionit dhe të merren veprimet e nevojshme për përmirësimin e situatës së krijuar. Pasqyrat financiare të Kompanisë duhet të përgatiten në një bazë e cila është e përshtatshme dhe e bazuar në realitetin ekonomik të Kompanisë. Nënshkrimi i pasqyrave nga KE dhe ZKFTH, duhet të bëhet vetëm nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme para se të njëjtat t'i dorëzohen BD-së.

¹ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja;
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura;
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në Ndërmarrjen Publike. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e të hyrave, shpenzimeve, pasurive, detyrimeve dhe llogarive të arkëtueshme.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në Kompaninë Telekom i Kosovës Sh.a, gjatë vitit 2018 ka pas ndryshime të shpeshta të menaxhmentit të lartë (kryeshefit ekzekutiv) po ashtu edhe pozita e ZKFTH ka pas ndryshime të vazhdueshme. Gjithashtu, deri në fund të muajit mars 2018 nuk ka pas as Bord të Drejtorëve.

Rezultatet tona të auditimit kanë nxjerrë në pah se Kompania nuk ka vendosur kontrolle adekuate në shumicën e aktiviteteve operative dhe financiare.

Më tutje, përmirësime të rëndësishme duhet të bëhen në shumicën e fushave si në menaxhimin e pasurive, menaxhimin e personelit, realizimin e shpenzimeve, sistemet e teknologjisë informative dhe në qeverisjen e mirë për të siguruar ngritje të cilësisë së shërbimeve ndaj klientëve dhe përmirësim të situatës financiare të Kompanisë.

Këto dhe dobësitë e tjera të prezantuara në këtë raport duhet të merren në konsideratë nga Bordi i Drejtorëve për të përmirësuar menaxhimin financiar dhe kontrollin në Telekomin e Kosovës.

3.1 Plani i biznesit (të hyra dhe shpenzimet)

Ne i kemi shqyrtuar burimet e të hyrave dhe shpenzimeve të planifikuara me planin vjetor të biznesit sipas kategorive përkatëse. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Tabela e të hyrave dhe shpenzimeve sipas planit vjetor për vitin 2018 (në €)

Përshkrimi	Planifikimi fillestar	Plani përfundimtar	Realizimi 2018	Realizimi 2017
Të hyrat nga shitjet/shërbimet	77,356,855	67,692,238	66,002,340	70,243,367
Të hyrat tjera	123,973	245,004	236,603	1,039,000
Gjithsej të hyrat	77,480,829	67,937,242	66,238,943	71,282,367
Shpenzimet për paga	27,054,365	27,921,832	28,137,710	26,700,699
Shpenzimet operative	19,957,508	16,119,381	17,483,391	16,682,238
Shpenzimet tjera	40,523,962	36,164,643	36,543,148	41,708,016
Gjithsej Shpenzimet	87,535,835	80,205,856	82,164,250	85,090,953

Shpjegimet rreth ndryshimeve në planifikimin dhe realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve janë dhënë si në vijim:

- Planifikimi fillestar i të hyrave nga shitjet/shërbimet ishte më i lartë sesa plani final/rishikuar për 9,664,617.34€ ose rreth 12.5%. Indikator kryesor për këtë ishte trendi i realizimit të të hyrave për pjesën e parë të viti 2018, andaj si rezultat i kësaj, në drejtim të një planifikimi më real, në planin me rishikim të hyrat janë paraparë më të ulëta sesa në atë fillestar. Megjithatë, ndërmarrja kishte realizim të mirë krahasuar me planin përfundimtar, e që shprehur në përqindje është rreth 97%;
- Planifikimi përfundimtar për paga dhe mëditje ishte më i lartë për 867,467 € krahasuar me planifikimin fillestar. Plani për këtë kategori për 2018 është realizuar për 215,878€ më shumë se plani përfundimtar;
- Planifikimi përfundimtar për shpenzime operative në raport me planifikimin fillestar është zvogëluar për 3,838,127 € ose rreth 19.23%. Përderisa realizimi për këtë kategori ishte për 1,364,010€ më tepër se plani përfundimtar;
- Planifikimi përfundimtar për shpenzime tjera në raport me planifikimin fillestar është zvogëluar për 4,359,319€ ose rreth 10.75%. Gjithashtu, realizimi për këtë kategori ishte më i lartë për 378,505€ krahasuar me planin përfundimtar.

Çështja A2 Tejkalime në realizimin e planit të biznesit

- Gjetja** Korniza ligjore kërkon që Ndërmarrja Publike të hartojë Planin e Biznesit duke përcaktuar shpenzimet e përgjithshme për ushtrimin e veprimtarisë si dhe mënyrën për financimin e shpenzimeve.
- Analizat tona tregojnë se ekzistojnë dallime të theksuara në mes të planifikimit fillestar dhe atij final për buxhetin e vitit 2018. Për më tepër, tejkalimet janë të dukshme edhe midis planit të rishikuar dhe realizimit për kategoritë paga dhe mëditje, shpenzime operative dhe shpenzime tjera.
- Rreziku** Proceset e dobëta të planifikimit sjellin ndërmarrjen në pozitë të tillë që rrezikon të mos arrijë ti përmbushë objektivat dhe të mos arrijë t'i mbulojë shpenzimet duke rritur obligimet ndaj furnitorëve.
- Rekomandimi A2** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që plani i biznesit bazohet mbi nevojat reale të Kompanisë, realizimi i tij monitorohet në mënyrë sistematike dhe ndryshimet apo devijimet e mëdha nga plani fillestar reflektohen saktë në planin e rishikuar.

3.2 Pasqyra e pozitës financiare

Kompania Telekom i Kosovës Sh.a në pasqyrën vijuese ka prezantuar Pasqyrën e pozitës financiare.

Tabela 2: Pasqyra e pozitës financiare (Balanci i Gjendjes)² më 31 dhjetor 2018 në € (të gjitha shumat janë në mijëra Euro, përveç nëse ceket ndryshe).

Pasuritë	Viti 2018	Viti 2017
Prona, impiantet dhe pajisjet	49,785	68,236
Asetet e patrupëzuara	11,659	11,597
Asetet financiare të disponueshme për shitje	2	2
Pasuria e tatimit të shtyrë	1,213	863
Stoqet	5,498	6,746
Llogaritë e arkëtueshme	9,456	7,915
Të arkëtueshmet e tatimit mbi të ardhurat	10	12
Shpenzimet e parapaguara dhe të arkëtueshme tjera	3,285	3,471
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	722	488
Gjithsej Pasuritë	81,630	99,330
Ekuiteti		
Kapitali themelor	4,475	4,475
Kapitali rezerve	55,000	55,000
Fitimet/Humbjet e mbajtura	(18,447)	(4,544)
Fitimet/Humbjet e vitit	(15,575)	(13,904)
Zërat tjerë		
Detyrimet		
Detyrimet afatgjata		
Llogaritë e pagueshme tregtare	9,256	10,419
Provizionet	24,789	27,467
Të pagueshmet tjera dhe akrualet	4,002	2,210
Të hyrat e shtyra	3,130	3,207
Dividendët e pagueshme	15,000	15,000
Gjithsejtë Detyrimet dhe Ekuiteti	81,630	99,330

Si rezultat i trajtimeve tona në aspektin e pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret kemi dhënë rekomandimet si më poshtë:

² SNK 1 termin “Balanci i Gjendjes” e kanë ndryshuar dhe emërtuar “Pasqyra e Pozitës Financiare”.

Çështja B1 - Mungesa e politikave të qarta të vlerësimeve kontabël

Gjetja Sipas Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 8 “Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet” dhe par.3.3 të “Kodit për Qeverisje Korporative, një njësi ekonomike zgjedh dhe zbaton politikat e tij kontabël me qëndrueshmëri për transaksione, ngjarje dhe kushte të tjera të ngjashme.

Përkundër faktit se Kompania ka një numër të rregulloreve sipas Ligjit për NP, ende nuk ka politika të qarta të gjykimeve dhe vlerësimeve kontabël për kategorinë e pasurive si: vlerësimi i duhur i pasurive financiare dhe jo financiare; jeta e dobishme e pasurive jo financiare ose modeli i pritshëm i konsumit të përfitimeve ekonomike të ardhshme të trupëzuara në pasuri. Kjo çështje ishte ngritur dhe rekomanduar edhe në vitin e kaluar.

Sipas zyrtarëve të Kompanisë kjo kishte ndodhur sepse është pezulluar përkohësisht aktiviteti për shkak të mungesës së komitetit të auditimit dhe për faktin se pas ristrukturimit të kompanisë është filluar me hartimin e SOP dhe që të mos bëhet punë e dyfishtë dhe të mos krijohen konflikte të përshkruara në politikat dhe procedurat kontabël me ato procedura në SOP.

Rreziku Në mungesë të këtyre politikave të vlerësimeve mund të cenohet pjesa thelbësore e përgatitjes së PF duke shkaktuar edhe keq deklarime të zërave material.

Rekomandimi B1 Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë marrë veprime konkrete për përcaktimin e politikave të qarta të vlerësimeve kontabël dhe t’i rishikoj ato për ndryshime e nevojshme.

Çështja B2 – Humbja në vlerë e pasurive dhe mostrajtimi i duhur i kësaj çështje

Gjetja

Sipas objektivit (1) të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 36 “Zhvlerësimi i aktiveve” dhe Standardit Kombëtar i Kosovës 3 par. 26, një njësi ekonomike duhet të përcaktojë procedurat të cilat i zbaton për të siguruar që pasuritë e saj mbahen me një vlerë kontabël e cila nuk duhet të jetë më e madhe se shuma e tyre e rikuperueshme. Një pasuri mbahet me një vlerë kontabël e cila është më e madhe se shuma e rikuperueshme nëse vlera kontabël neto e saj e kalon shumën që mund të rikuperohet përmes përdorimit ose shitjes së aktivit. Nëse është kështu, thuhet se aktivi është i zhvlerësuar dhe Standardi kërkon që njësia ekonomike të njohë një humbje nga zhvlerësimi. Pasuritë jo-financiare që kanë pësuar humbje në vlerë rishikohen për ndryshim të mundshëm të humbjes në vlerë në secilën datë raportuese.

Në procesin e zbatimit të politikave kontabël menaxhmenti i kompanisë nuk ka bërë asnjë gjykim i cili mund të ketë efekt të rëndësishëm lidhur me rënien në vlerë të pasurive e cila përcaktohet duke kryer testimin nëpërmjet të cilit vlerësohet shuma e rikuperueshme. Ekzistojnë situata të qarta për përcaktimin nevojës për testin e zhvlerësimit për pasuritë që tregojnë shenja të rënies në vlerë në datën e bilancit si:

- Pjesa e konsiderueshme e pasurive janë të teknologjisë informative të cilat kanë një treg dinamik dhe vlera e tregut të pasurive të ngjashme ka rënë;
- Mungesa e mirëmbajtjes dhe e përkrahjes teknologjike e cila bart një kosto të lartë vije në pikëpyetje vlerën e përgjithshme të platformës së përgjithshme;
- Nuk ka vlerësim të pasurive jashtë përdorimit të gjeneratës teknologjike paraprake të cilat mund të ripërdoren për riparime potenciale;
- Vlera kontabël e një pjese të pasurive neto të njësisë ekonomike mund të jetë më e madhe se vlera e tregut;
- Gjendja fizike e pasurive dhe performanca e tyre është përkeqësuar;

Sipas zyrtarëve të Kompanisë për shkaqe të kufizimeve buxhetore nga trendi i realizimit të të hyrave për vitet 2016-2017, menaxhmenti nuk ka mundur që këtë projekt të përfshijë në kuadër të projekteve me “Prioritet Shumë të Lartë”. Po ashtu, për shkak të situatës financiare të Kompanisë, është vështirë të planifikohet ri-incimi i përfshirjes së këtij projekti në rishikimin e Buxhetit në gjysmë-periudhën e vitit 2019.

Rreziku Mungesa e vazhdueshme e testit të zhvlerësimit të pasurive mund të ndikoj në prezantimin joreal të vlerës së tyre dhe të shpenzimeve nga humbja në PF.

Rekomandimi B2 Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë marrë vendime për kryerjen e procedurës për testim të rënies në vlerë të pasurive duke dokumentuar atë sa më qartë, në mënyrë që të prezantohet një vlerë reale e pasurive dhe të eliminohen mundësitë e keq deklarimit të shpenzimeve në pasqyra financiare.

3.3 Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Kompania Telekom i Kosovës Sh.a në pasqyrën vijuese ka prezantuar të gjitha llojet e të hyrave që ka krijuar gjatë vitit, shpenzimet, si dhe rezultatin financiar.

Tabela 3: Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve më 31 dhjetor 2018, në € (të gjitha shumat janë në mijëra Euro, përveç nëse ceket ndryshe).

Përshkrimi	Viti 2018	Viti 2017
Të hyrat nga shitjet/shërbimet	66,002	70,243
Të hyrat nga granti		
Të hyrat tjera	236.60	1,039
Gjithsej të Hyrat	66,239	71,282
Pagat dhe mëditjet	28,138	26,701
Shpenzimet e derivateve	235	261
Shpenzimet e materialit/shërbimeve	15,920	14,857
Shpenzimet të zyrës dhe administrative	876	779
Shpenzimet për mirëmbajtje	1,488	1,695
Shpenzimet e zhvlerësimit	12,994	13,147
Shpenzimet e amortizimit	7,405	9,651
Shpenzimet tjera	15,109	17,999
Gjithsej Shpenzimet	82,164	85,091
Fitimi/Humbja para tatimit	(15,925)	(13,809)
Tatimi në fitim - Të ardhurat/ (shpenzimi) i tatimit mbi të ardhura	350.00	(95)
Fitimi/Humbja neto	(15,575)	(13,904)

Të hyrat e realizuara ishin 66,238,943€, përderisa planifikimi i të hyrave për vitin 2018 ishte 67,937,242€.

Shpenzimet e realizuara (pa zhvlerësim dhe amortizim) në vitin 2018 ishin 61,766,092€, përderisa planifikimi për vitin 2018 ishte 58,794,096€. Prej këtyre shpenzimeve të realizuara 28,137,710€ ose shprehur në përqindje rreth 45.5% i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve (shpenzimeve të personelit).

Ekzaminimet tona audituese në pajtueshmëri, kanë rezultuar me gjetjet në vijim:

Çështja A3 - Mos emërimi i zyrtarit për certifikimin e pagesave

Gjetja Sipas Ligjit për Financa Publike dhe Përgjegjësitë kërkohet që “Çdo Organizatë Buxhetore, agjenci autonome ekzekutive dhe ndërmarrje publike duhet ta ketë Zyrtarin Certifikues. Zyrtari Certifikues emërohet dhe i raporton Zyrtarit Kryesor Administrativ”.

Kompania nuk kishte emëruar ende një zyrtar për certifikimin e pagesave. Këtë rol pjesërisht e mbulon, Menaxheri i Thesarit, mirëpo kjo nuk është një ndarje e duhur e detyrave pasi që i njëjti menaxhon edhe me llogaritë bankare dhe bën ekzekutimin e pagesave.

Mos emërimi i zyrtarit për certifikimin e pagesave ka ndodhur për shkak të dështimit të menaxhmentit për të vendosur kontrollet dhe pozitat e duhura në kompani.

Rreziku Mungesa e Zyrtarit Certifikues zbeh kontrollet e brendshme dhe mos ndarja e duhur e detyrave mund të shpie në konflikt interesi për zyrtarin.

Rekomandimi A3 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që ekziston ndarje e duhur e detyrave dhe përgjegjësi në kompani duke ndërmarrë veprimet adekuate për vendosjen e kësaj pozite në mënyrë që të forcoj kontrollet dhe të parandaloj konfliktet e mundshme të interesit.

Çështja A4 - Pagesa të proceduara pa u nënshkruar nga menaxheri i thesarit

E gjetura Sipas procedurave standarde të operimit (SOP) për financa të hartuara nga kompania, tek pjesa Aprovimit të Faturave, kërkohet që “Asnjë faturë të mos paguhet, nëse mungon një nga nënshkrimet e cekura si në vijim: Koordinatori për raportim dhe planifikim, menaxheri/projekt menaxheri, drejtori (i sektorit/departamentit kërkues) dhe menaxheri i Thesarit”.

Nga 11 rastet e testuara në pesë raste ky kontroll nuk ishte zbatuar nga menaxheri i Thesarit dhe lënda ishte proceduar për pagesë pa nënshkrimin e tij.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mos aplikimit të kontrolleve efektive nga ZKFTH.

Rreziku Mos vendosja e kontrolleve me rastin e realizimit të shpenzimeve dhe mos aprovimi i tyre në mënyrë formale nga personat përgjegjës të kompanisë, e rritë rrezikun e menaxhimit jo racional dhe efikas të shpenzimeve dhe kjo mund t'i shkaktoj ndërmarrjes humbje financiare të pa nevojshme.

Rekomandimi A4 Kryesuesi i Bordit të sigurojë që janë ndërmarr masat për vendosjen e kontrolleve adekuate në kompani dhe se aprovimi i shpenzimeve bëhet nga personat përgjegjës për menaxhim më efikas dhe racional të shpenzimeve.

Çështja A5 - Mungesa e planit të menaxhimit të kontratës

Gjetja Sipas RRUOPP, neni 61.8, “Plani për menaxhimin e kontratës do të përgatitet para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtimin e palëve të përfshira në kontratë. Kjo do të dokumentohet me nënshkrimin e dy palëve, përkatësisht Menaxherit të Projektit dhe Operatorit Ekonomik.”

Në dy raste, tek procedurat e prokurimit “Blerja e Kontentit të IPTV” dhe “Furnizim me Pajisje Telekomunikuese Mobile”, mungon plani për menaxhimin e kontratës.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mos aplikimit të kontrolleve efektive nga autoriteti kontraktues.

Rreziku Mos zbatimi i plotë i kërkesave ligjore të prokurimit, mund të rezultojë në menaxhim të dobët në implementimin e kontratave.

Rekomandimi A5 Kryesuesi i Bordit të sigurojë që një rishikim i brendshëm po ndërmerret për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në të gjitha rastet dhe të ushtrojë më shumë kontrolle për të siguruar se mangësitë e identifikuara janë adresuar.

Çështja A6 - Planifikimi dhe realizimi jo i duhur i planit të prokurimit

Gjetja Neni 5 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik (RRUOPP) thotë se përgatitja e planit vjetor të prokurimit: Eliminon nevojën për prokurime emergjente apo përjashtime; Mbledhë kërkesat, kur është e mundur, për të fituar vlerën për paranë; Mundëson identifikimin e kontratave kornizë; dhe Eviton ndarjen e kërkesave të prokurimit që janë kryesisht të njëjta ose të ndërlidhura.

Kompania kishte hartuar planin e prokurimit prej 85 procedurave me vlerë totale të parashikuar 13,415,774€. Gjatë vitit, ishin nënshkruar 80 kontrata në vlerë prej 2,940,730.91€ prej të cilave 40 ishin realizuar përmes procedurës së vlerës minimale dhe kuotimit të çmimeve.

Ne, kemi vërejtur që për kërkesat kryesisht të njëjta ose të ndërlidhura furnizimeve/shërbimeve janë zhvilluar disa procedura duke rezultuar me ndarje të kërkesave: Projektet “Furnizim me pajisje të IT-së dhe “Furnizim me pjesë rezervë të IT-së”, janë projekte që kanë kërkesa kryesisht të njëjta ose të ndërlidhura dhe për këto dy projekte janë zhvilluar 17 aktivitete të prokurimit, nga të cilat tetë aktivitete janë zhvilluar me procedura sipas koutimit të çmimeve dhe pesë procedura me vlerë minimale.

Një ndarje e tillë e kërkesave/ nevojave ka ndodhur si pasojë planifikimit jo të duhur nga njësitë kërkuese.

Rreziku Ndarja e kërkesave që janë të njëjta ose të ndërlidhura në procedura të koutimit të çmimeve dhe procedura të vlerës minimale shkurton afatet e procedurës së tenderimit duke rritur rrezikun e eliminimit të konkurrencës dhe vë në pikëpyetje cilësinë e shërbimeve/ produkteve të pranuar për paranë e dhënë.

Rekomandimi A6 Kryesuesi i Bordit të sigurojë një planifikim të detajuar të aktiviteteve të prokurimit i cili do të shmangë në të ardhmen nevojat për ndarjen e kërkesave, si dhe do të sigurojë aplikimin e procedurave të duhura siç janë kontratat publike kornizë.

Çështja A7 - Angazhimi i punëtorëve për punë dhe detyra specifike në pozita të rregullta pa konkurs publik

Gjetja Sipas Ligjit të punës, Nr. 03/L-212, neni 8, pika 1, kërkohet që “Punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës”. Gjithashtu, Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 - Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, neni 4, pika 3, kërkon: “Konkursi publik mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit dhe duhet të publikohet së paku në njërën nga mjetet e shkruara të informimit”.

Kompania, gjatë vitit 2018 kishte angazhuar 178 punonjës për punë dhe detyra specifike, pa shpallur konkurs publik.

Arsyeja e angazhimeve të tilla ishte se kompania, nuk e kishte konsideruar si të nevojshme shpalljen e konkursit publik për angazhimin e punonjësve për punë dhe detyra specifike. Për më tepër, në përgjigjen e tyre jepen këto sqarime: angazhimi i stafit me punë dhe detyra specifike në parim është realizuar; thirrja për shprehje të interesit është plasuar në web faqe të kompanisë dhe në hyrje të objekteve kryesore të Telekomit, është bërë identifikimi i nevojave të stafit nga departamentet kërkuese dhe përmes angazhimit të stafit përcjellës nga secili Kryeshefi Ekzekutiv për kabinetet e tyre.

Rreziku Angazhimi i punonjësve për punë dhe detyra specifike për pozita të rregullta të punës pa respektuar parimet bazë për një proces fer, transparent dhe konkurrues, përveç që mund të mos jetë në harmoni me obligimet ligjore, rritë rrezikun e angazhimit të personave jo të duhur në pozitat e caktuara.

Rekomandimi A7 Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë shqyrtuar shkaqet që kanë krijuar mangësitë e identifikuara dhe se janë marrë masat e nevojshme që të respektohen dispozitat ligjore përkatëse me rastin e angazhimeve të punonjësve të rinj.

Çështja A8 - Tejkalimi i afatit për angazhim të punonjësve për punë dhe detyra specifike

Gjetja Në Ligjin e punës Nr. 03/L-212, neni 10, paragrafi 6, thuhet se “Kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë se njëqindnjëzet (120) ditë brenda një (1) viti”.

Testimet tona tregojnë se në 65 raste kompania kishte angazhuar punonjës për punë dhe detyra specifike, duke mos respektuar afatin maksimal të punësimit sipas kësaj mënyre të kontraktimit.

Tejkalimin e afatit të angazhimit kompania e ka arsyetuar se ka ndodhur për shkak të nevojave të departamenteve kërkuese.

Rreziku Angazhimi i punëtorëve më gjatë se afati maksimal i lejuar rrezikon angazhimin e personave jo kompetentë për pozita përkatëse dhe rrit kostot e ndërmarrjes si dhe mund të rezultojë në mos efikasitetin operacional.

Rekomandimi A8 Kryesuesi i Bordit të sigurojë që përmes akteve të brendshme të ndërmarrjes të fuqizojë kontrollin e brendshme, të cilat do të pamundësojnë lidhjen e kontratave për punë dhe detyra specifike më gjatë se afati maksimal i lejuar me ligj.

Çështja A9 - Pozita të njëjta të punës që paguhen me grada të ndryshme

Gjetja Në Ligjin e punës Nr. 03/L-212, neni 55, paragrafi 3, thuhet se “Punëdhënësi duhet t’i paguajë femrave dhe meshkujve kompensimin e njëjtë për punën e vlerës së njëjtë, kompensim i cili mbulon pagën bazë dhe shtesat e tjera”.

Gjatë rishikimit të listës së punonjësve 31.12.2018, ne kemi identifikuar 61 pozita ku punonjësit nuk paguhen me grada të njëjta për pozitën e njëjtë.

Sipas përgjigjes së kompanisë arsyet për rastet e identifikuara kur punonjësit me pozita të njëjta paguhen me grada të ndryshme janë: kualifikimi shkollor dhe përvoja, dallimi në mes punës në departamente, ndryshime me vendime gjyqësore, i punësuar përmes konkursit publik me gradë përkatëse, mirëpo këto nuk janë kritere që i ka paraparë ligji apo ndonjë rregullore e brendshme e Kompanisë dhe punonjësi duhet të paguhet për detyrën që kryen dhe përgjegjësitë që ka.

Rreziku Pagesa e punonjësve për pozita të njëjta me grada të ndryshme rrit rrezikun e pakënaqësisë së punonjësve të cilët edhe mund të ngritin padi eventuale ndaj kompanisë për mos trajtim të barabartë.

Rekomandimi A9 Kryesuesi i Bordit të sigurojë që përmes akteve të brendshme të fuqizojë kontrollin e brendshme, të cilat do të pamundësojnë që punonjësit në pozitat e njëjta paguhen me grada të ndryshme.

Çështja A10 - Lëvizjet e stafit pa ndonjë kriter prej njëres gradë dhe/ ose pozitë në gradën dhe/ose pozitën tjetër

Gjetja Kodi i Etikës dhe Qeverisja Korporative për Ndërmarrjet Publike i publikuar nga Njësia për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike, tek kapitulli 12, Protokollet tjera të punësimit, përkatësisht 12.18 dhe 12.20 thuhet se: “Ndërmarrja do të rekrutoj dhe përkrahë punonjësit pa diskriminim në bazë të përshtatshmërisë së tyre për punë”; “Ndërmarrja do të inkurajoj dhe ndihmoj punëtorët në të gjitha nivelet e zhvillimit përkatës të aftësive dhe progresit në karrierën e tyre”.

Në Politikën e rekrutimit dhe seleksionimit nuk janë paraparë kritere për lëvizjet e stafit në grada dhe pozita, mirëpo këto gradime në bazë të politikës në fuqi janë nën kompetencën e Kryeshefit Ekzekutiv në bashkëpunim me departamentin e Burimeve Njerëzore dhe departamentet përkatëse kërkuese.

Kompania, gjatë vitit 2018, kishte bërë 296 lëvizje të stafit në pozita dhe grada. Ne kemi rishikuar listën e lëvizjes së stafit dhe nuk kemi gjetur argumente se cili kriter është përdorur në lëvizjet e stafit p.sh. prej gradës 5 në gradën 14, prej 7 në gradën 15, prej gradës 9 në gradën 12, prej gradës 10 në 14, prej gradës 10 në gradën 15.

Kjo ka ndodhur si shkak i mungesës së kritereve të qarta dhe të përcaktuara për lëvizjet e stafit në Politiken e seleksionimit dhe rekrutimit.

Rreziku Në mungesë të një politike për avancimet rritet rreziku për trajtim jo të barabartë të dhe mund të krijojë diskriminime në gradimin e stafit.

Rekomandimi A10 Kryesuesi i Bordit të sigurojë hartimin e rregullores së gradimeve dhe që gradimi i stafit dhe degradimi bëhen në bazë të kritereve të vendosura në rregullore/politikë e cila duhet të jetë e aprovuar në Bordin e drejtorëve.

Çështja A11 - Rregulloret dhe politikat për menaxhimin e personelit të pa aprovuara në Bord

Gjetja Me Statut të Ndërmarrjes parashihet që “Shoqëria, duhet të nxjerrë, rregulloret, të cilat përmbajnë dispozita për administrimin dhe funksionimin e shoqërisë të miratuara nga Bordi i drejtorëve.

Ne kemi pranuar një set të rregulloreve dhe politikave të burimeve njerëzore që janë në fuqi, mirëpo përveç “Politikës së seleksionimit dhe rekrutimit” e cila ishte aprovuar në Bord, rregulloret dhe politikat tjera ishin të aprovuara vetëm nga Kryeshefi ekzekutiv dhe disa tjera janë ekzistojnë vetëm si dokumente dhe nuk janë të aprovuara fare.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos aplikimit të kontrolleve efektive nga Bordi i drejtorëve ndaj Menaxhmentit të Kompanisë.

Rreziku Mos aprovimi nga Bordi i drejtorëve i rregulloreve dhe politikave të burimeve njerëzore, rritë rrezikun e mungesës së llogaridhënies së Menaxhmentit të Kompanisë në menaxhimin e personelit.

Rekomandimi A11 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se të gjitha rregulloret dhe politikat e hartuara për burimet njerëzore janë miratuar. Për më tepër, të bëhet një rishikim i brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e statutit të ndërmarrjes, ligjit për ndërmarrjet publike, kodit të etikës dhe qeverisjes korporative për ndërmarrjet publike nuk janë adresuar deri më tani.

3.4 Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

Në Pasqyrat Vjetore Financiare të Kompanisë, kapitali është prezantuar sipas kësaj strukture:

Tabela 4: Kapitali i Ndërmarrjes publike TK më 31.12.2018 (të gjitha shumat janë në mijëra Euro, përveç nëse ceket ndryshe).

Përshkrimi	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
KAPITALI		
Kapitali themeltar	4,475	4,475
Kapitali rezervë	55,000	55,000
Fitimet/Humbjet e bartura	(18,447)	(4,544)
Fitimet/Humbja e vitit aktual	(15,575)	(13,904)
Rezerva e rivlerësimit	-	-
Gjithsej	25,453	41,027

3.5 Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme

Pasqyra e rrjedhës së parasë jep të dhëna për ndryshimet në para të gatshme gjatë periudhave raportuese të paraqitura dhe klasifikon rrjedhën e parave që arrihet nëpërmjet aktiviteteve operative, investuese dhe ato financiare. Informatat rreth rrjedhës së parave të kompanisë janë të dobishme për t'i dhënë shfrytëzuesit të pasqyrave financiare një vlerësim të rrjedhës së parave.

Kompania Telekom i Kosovës në pasqyrën vijuese ka prezantuar Pasqyrën e Rrjedhës së Parasë së Gatshme.

Tabela 5: Pranimet dhe shpenzimet e parasë së gatshme në € (të gjitha shumat janë në mijëra Euro, përveç nëse ceket ndryshe)

Përshkrimi	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</i>		
Korrigjimi për zhvlerësim	12,994	13,147
Korrigjimet tjera rritëse	7,405	9,650
Zvogëlimi i parasë (Humbja para tatimit dhe tjera)	(22,416)	-50,842
Rregullimet tjera rritëse zvogëluese	4,261	37,991
Rrjedha neto nga aktivitetet operative	2,243	9,946
<i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investive</i>		
Rritja e parasë		
Zvogëlimi i parasë	(2,009)	(10,144)
Paratë neto nga aktivitetet investive	(2,009)	(10,144)
<i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</i>		
Rritja e parasë		
Zvogëlimi i parasë		
Paratë neto nga aktivitetet financuese	0	0
Rritja /zvogëlimi i parasë gjatë vitit	234	(198)
Paraja në fillim të vitit	488	686
Paraja në fund të vitit	722	488

3.6 Trajtimi i shënimeve shpjeguese

Shënimet shpjeguese, paraqesin informacion lidhur me bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikave kontabël, të kërkuar nga SNRF-të dhe japin informacione shtesë të cilat nuk janë paraqitur në Bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë ose pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, por janë të rëndësishme për t'i kuptuar cilëndo prej tyre.

Çështjet e shpalosjeve lidhur me vijimësinë të paraqitura në mënyrë jo të duhur në PFV, janë paraqitur në pikën 2 të këtij raporti, konkretisht në bazën për Opinion të Kundërt.

4 Qeverisja e mirë

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë auditimi i brendshëm, procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjerë janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Në përgjithësi qeverisja e mirë lidhur me aktivitete operationale/biznesore dhe financiare në Telekomin e Kosovës vazhdon të jetë e brishtë. Kompania nuk ka progres në zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditori i pavarur për vitin 2017. Gjithashtu, nuk ka politika të hartuara për vlerësim, identifikim dhe përcaktim të rreziqeve nëpërmjet regjistrit të rreziqeve si dhe mungon menaxhimi i rreziqeve.

Më tutje, nuk është bërë vetëvlerësimi i performancës së Bordit të drejtorëve dhe mungon doracaku për menaxhim të pasurive.

Auditimi i brendshëm kishte ofruar një pasqyrë mbi nivelin e sigurisë së kontroleve të brendshme dhe kishte dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre. Mirëpo edhe kjo njësi nuk ka hartuar një plan të bazuar në rreziqe, nuk ka politika dhe procedura të aktiviteteve të saj, nuk ka statut të auditimit si dhe nuk ka as plan strategjik të auditimit.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me pesë zyrtarë/anëtarë të stafit. Prej tyre, dy auditorë, një UD Menaxher i Auditimit të Brendshëm për TI, një Menaxher i Auditimit të Brendshëm dhe një Asistente Personale/Përkthyesë si dhe Drejtuesja e kësaj njësie, e cila është zgjedhur në nëntor të vitit 2018.

Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës, i cili reflekton rreziqet financiare dhe rreziqet tjera të kompanisë si dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm, duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti zbatimit të rekomandimeve të auditimit.

Njësia e AB-së ka përgatitur një formë të planit vjetor të auditimit, i cili nuk ishte i bazuar në rreziqe dhe i njëjti në mungesë të Bordit dhe Komitetit të auditimit (në kohën e përgatitjes së planit) nuk është i aprovuar. Në këtë plan të auditimit, NJAB për vitin 2018 ka planifikuar tetë auditime, prej të cilave gjatë vitit 2018 kishte realizuar tre auditime ndërsa dy auditime nga ky plan ishin përfunduar në vitin 2019. Përveç këtyre, NJAB kishte realizuar edhe nëntë aktivitete me kërkesë të menaxhmentit. Në përgjithësi raportet NJAB-së ishin gjithëpërfshirëse duke dhënë rekomandime lidhur me përmirësimin e kontrollit të brendshëm.

Çështja A12 - Mos-hartimi i Statutit të Auditimit të Brendshëm

Gjetja Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (SNPPAB) 1000 parashohin që qëllimi, autoriteti dhe përgjegjësia e aktivitetit të auditimit të brendshëm duhet të përcaktohet formalisht në Statutin e Auditimit të Brendshëm, në përputhje me Përkufizimin e Auditimit të Brendshëm, Kodin e Etikës dhe Standardeve.

NJAB nuk kishte hartuar Statutin e Auditimit të Brendshëm sipas kërkesave të standardit.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së vëmendjes nga komiteti i auditimit dhe departamentit të auditimit për ta përgatitur këtë dokument formal.

Rreziku Mungesa e statutit të auditimit e rritë rrezikun që të mos përcaktohet qartë qëllimi, pozicioni, autoriteti dhe përgjegjësia e aktiviteteve të auditimit të brendshëm në kompani.

Rekomandimi A12 Kryesuesi i Bordit në bashkëpunim me Komitetin e Auditimit të sigurojë që është hartuar statuti i AB-së, duke përcaktuar qartë përmes këtij dokumenti formal (statutit): qëllimin, pozicionin, autoritetin dhe përgjegjësinë e aktiviteteve të auditimit të brendshëm në kompani.

Çështja A13 - Mos-hartimi i planit strategjik dhe planit të auditimit të bazuar në rrezik**Gjetja**

Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm 2010 dhe 2200, parashohin që Drejtuesi i auditimit të brendshëm të vendosë një plan auditimi të bazuar në rrezik dhe të dokumentojë një plan për secilin angazhim duke përfshirë objektivat, fushën, kohën dhe shpërndarjen e burimeve të angazhimit.

Departamenti i auditimit të brendshëm kishte hartuar një plan ku kishte paraparë disa angazhime (i njëjti nuk ishte aprovuar në mungesë të bordit në atë periudhë), megjithatë ky plan nuk ishte i bazuar në rrezik. Për më tej, ky departament nuk ka as plan strategjik.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mosinteresimit nga komiteti i auditimit dhe departamentit të auditimit për të hartuar një plan të bazuar në rrezik dhe planin strategjik.

Rreziku

Mos hartimi i planit të auditimit bazuar në rrezik dhe planit strategjik nga departamenti i auditimit të brendshëm e rritë rrezikun që të mos përcaktohen përparësitë e aktivitetit të auditimit të brendshëm në linjë me synimet, objektivat kyçe, strategjitë e ndërmarrjes si dhe rreziqet përkatëse dhe proceset e administrimit të rrezikut.

Rekomandimi A13

Kryesuesi i Bordit në bashkëpunim me Komitetin e Auditimit, të sigurojë që është hartuar plani i auditimit bazuar në rrezik si dhe plani strategjik duke përfshirë objektivat, fushën, kohën dhe shpërndarjen e burimeve të angazhimit. Plani duhet të konsiderojë strategjitë e Ndërmarrjes, objektivat dhe rreziqet e lidhura me angazhimin.

Çështja A14 – Mos hartimi i Politikave dhe procedurave të aktiviteteve të auditimit të brendshëm

Gjetja Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm 2040, kërkojnë që Drejtuesi i auditimit të brendshëm të vendosë politika dhe procedura që shërbejnë si udhëzues për aktivitetin e auditimit të brendshëm.

Departamenti i auditimit të brendshëm nuk ka politika dhe procedura të hartuara që rregullojnë procesin e auditimit të brendshëm. Kjo ka ndodhë si rezultat i mungesës së iniciativës nga ky departament.

Rreziku Në mungesë të këtyre politikave dhe procedurave, NJAB-së mund të bëjë anashkalime të praktikave profesionale të auditimit të brendshëm dhe rrjedhimisht të mos arrijë ti shërbejë qëllimit për të cilin është formuar kjo njësi.

Rekomandimi A14 Kryesuesi i Bordit në bashkëpunim me Komitetin e Auditimit, të sigurojnë që janë ndërmarr hapa konkret për hartimin e politikave dhe procedurave për ushtrimin e aktiviteteve të AB-së në mënyrë që të definohen qartë detyrat dhe përgjegjësitë e kësaj njësie.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë Kompaninë.

Gjatë analizave tona lidhur me funksionimin e sistemeve menaxheriale, ne kemi vërejtur mangësitë si në vijim:

Çështja A15 - Mos hartimi i planit për menaxhimin e rreziqeve

E gjetura Në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike par. 15.9 si dhe në parimin nr. 5 të standardeve të “Qeverisjes së Mirë” në mesin e detyrave dhe përgjegjësive të Bordit është vendosja e politikave për menaxhimin e rrezikut dhe kontrollin nëpërmjet indikatorëve të rrezikut të biznesit.

Kompania ka të hartuar Planin e Biznesit 2017-2019, në të cilin janë listuar disa rreziqe pa i dhënë gjasat e ndodhjes dhe ndikimin e tyre, pa një prioritet të tyre sipas kategorisë dhe klasifikimit si dhe pa matje të rreziqeve për kundërveprime të lidhur me to. Për më tepër, ende nuk ka politika të hartuara për vlerësim, identifikim dhe përcaktim të rreziqeve nëpërmjet regjistrit të rreziqeve sipas prioritetit apo llojit të paraparë. Po ashtu nuk ka bërë hapa konkret në drejtim të vendosjes së sistemit për menaxhimin e rreziqeve.

Edhe pse Bordi në takimet e tyre të rregullta ka vënë në diskutim çështjet që lidhen me rreziqet potenciale ndaj Kompanisë, ende nuk kanë ndërmarrë veprime konkrete për ta formalizuar këtë proces.

Rreziku Mungesa e një regjistri formal të rreziqeve potenciale, ndikon në pamundësinë e ndërmarrjes për të reaguar me kohë apo për t'i reduktuar rreziqet në nivele të pranueshme.

Rekomandimi A15 Kryesuesi i Bordit të sigurojë se është hartuar një plan i cili do të identifikoj të gjitha rreziqet e mundshme, të vlerësoj ndikimin e tyre në rast se ato ndodhin, si dhe të përcaktoj masat parandaluese dhe ato të mëvonshme si përgjigje ndaj tyre.

Çështja A16 - Mungesa e doracakut për menaxhimin e pasurive

Gjetja Sipas Standardit Ndërkombëtar të Qeverisjes 9160 “Përmirësimi i qeverisjes së mirë për Pasuritë Publike” par.3.1 një udhëzues (Doracak) për politikën dhe procedurat e menaxhimit të pasurive është element kyç i ambientit të kontrollit të brendshëm.

Kompania nuk kishte hartuar një Doracak për menaxhimin e përgjithshëm të pasurive që përfshin gjashtë elemente: Planifikimin, buxhetimin kapital, blerjet, regjistrimet kontabël, menaxhimin dhe shitjet/shlyerjet. Kjo kishte ndodhur si rezultat i vëmendjes së pamjaftueshme të menaxhmentit lidhur me menaxhimin e fushës së pasurisë.

Rreziku Në mungesë të një Doracaku për menaxhimin e pasurisë mund të rezultojë me anomali materiale në fushën e pasurisë dhe rrezikon që kompania mos ti kryej aktivitetet e saj financiare dhe operative në bazë të ligjeve dhe standardeve të aplikueshme.

Rekomandimi A16 Kryesuesi i Bordit të sigurojë hartimin dhe vënien në përdorim të një doracaku ku do të përcaktohen elementet kryesore të cilat janë të domosdoshme për të ndihmuar në menaxhimin e fushës së pasurisë, si dhe t'i rishikoj ato në mënyrë periodike për të qenë në hap me ndryshimet e standardeve të qeverisjes.

Çështja A17 – Mos kryerja e vetëvlerësimit të performancës të Bordit të drejtorëve

Gjetja Sipas Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për NP par. 27.2, Ligjit mbi NP nr. 03/L-087 neni 28 par.(1) kërkohet që Bordi i drejtorëve të NP-së në baza vjetore të bëjë një vlerësim sistematik të performancës së vet duke përdorur kriteret e vlerësimit ose koeficientet. Kryesuesi është përgjegjës për të siguruar kryerjen e rregullt dhe me kohë të vlerësimit. Ndërsa sipas par.(2) Bordi duhet të sigurojë që rezultatet e vlerësimit të realizuar sipas paragrafit 1 të këtij neni të përmbliidhen në një raport me shkrim i cili i dërgohet Ministrit dhe Qeverisë së Kosovës për NP-të Qendrore.

Bordi i drejtorëve nuk ka kryer një vetëvlerësim për performancën e tij. Me moskryerjen të këtij vlerësimi nuk dihet se deri ku janë realizuar objektivat, si e definojnë Bordi rolin dhe detyrat në situatën aktuale në monitorimin e performancës së Kompanisë, si e bën prioritizimin e përgjegjësive, delegimet, komunikimet me stafin e brendshëm, NJPMNP dhe publikun.

Mungesa e përgjegjësisë dhe llogaridhënies për transparencë nga ana e Bordit si dhe dobësitë në mekanizma të mbikëqyrjes nga ana e Qeverisë së Kosovës siç është NJPMNP kanë rezultuar me mos respektimin e Qeverisjes Koorporative dhe Ligjit për NP.

Rreziku Në mungesë të këtyre vlerësimeve nuk mund të dihen objektivat konkrete të përkthyer nga Plani i Biznesit dhe aktivitetet për realizimin e këtyre objektivave të cilat paraqiten në fillim të vitit fiskal me një plan konkret në synim të rritjes së vlerës së Kompanisë. Kjo rrezikon transparencën, përgjegjësinë dhe llogaridhënien në realizimin e objektivave strategjike.

Rekomandimi A17 Kryesuesi i Bordit të sigurojë se është kryer vetëvlerësimi i performancës së Bordit në bazë të kriterëve të caktuara nga ana e NJPMNP e cila duhet të përfundojë me një plan konkret në fillim të vitit fiskal për të gjitha objektivat që duhet t'i realizoj deri fund të vitit. Ky aktivitet duhet të përfshijë edhe aktivitetet kryesore që duhet të ndërmerren për realizimin e secilës objektivë të paraparë në planin e biznesit.

5 Sistemet informative

Objektivi i këtij auditimi ka qenë që të vlerësohet nëse të dhënat që regjistrohen dhe përpunohen në Sistemet Informative të Telekomit të Kosovës kanë ndodhur në sistemet hyrëse, janë transferuar në mënyrë të saktë, të plotë dhe të besueshme në sistemet tjera informative të Telekomit dhe kanë ruajtur integritetin gjatë ciklit të përpunimit të tyre.

Konkluzioni i Përgjithshëm

Telekomi ka mangësi në kontrollet e të dhënave që transferohen në sistemet e informacionit brenda Kompanisë si dhe ka mungesë të harmonizimit të të dhënave. Mungesa e kontrolleve dhe mos harmonizimi i të dhënave, jep pasiguri se të gjitha ngjarjet e ndodhura transferohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në të gjitha sistemet e informacionit brenda Kompanisë.

Kompania nuk bënë rishikim periodik të të drejtave të qasjeve të përdoruesve. Këto të drejta nuk ndërpriten në momentin e ndërprerjes së kontratës apo ndërrimit të pozitës së punës. Po ashtu, nuk ka kontrolle të aktiviteteve të përdoruesve me qasje të plotë (administrator) dhe aktiviteteve të përdoruesve kontraktues për mirëmbajtje të sistemeve. Mungesa e kontrollit të përdoruesve rrezikon sigurinë e integritetit të informacionit, konfidencialitetin e të dhënave të ndjeshme si dhe rrezikon disponueshmërinë e sistemeve.

Përpjekjet me qëllim të identifikimit, korigjimit dhe parandalimit të humbjeve, mashtrimeve, kualitetit të shërbimeve dhe ngritjes së margjinave të fitimit të Kompanisë kanë qenë të mangëta. Identifikimi me vonesë i incidenteve, mungesa e konfigurimeve të alarmeve të sigurisë si dhe mosfunktionimi i alarmeve rrezikojnë rrjedhën dhe humbjen e të hyrave financiare e gjithashtu humbjen konsumatorëve që Kompania i posedon.

5.1 Kontrollet e aplikacioneve për të dhënat me ndikim financiar

Kontrollet e aplikacioneve janë kontrolle që bëhen për tu siguruar që transaksionet e ekzekutuara, procesimi i të dhënave, mbajtja e regjistrave si dhe kontrollet e brendshme mbështesin procesin e aktiviteteve të kompanisë.

Si rezultat i kontrolleve të të dhënave me ndikim financiar, ne kemi vërejtur mangësitë si në vijim:

Çështja A18 Nuk ka krahasim ndërmjet trafikut të regjistruar në SWITCH³-at e rrjetit qendror dhe sistemeve të faturimit.

Gjetja Të gjitha thirrjet, mesazhet telefonike, interneti, gjenerojnë trafik, dhe ky trafik duhet të regjistrohet në qendrën e SWITCH-ve, prej së cilave krijohen CDR-të (Detajet e Shënimeve të Thirrjes) dhe transferohen nëpër sistemet përkatëse.

Kompania deri më tani nuk ka arritur të bëjë krahasime ndërmjet sistemeve për t'u siguruar se i gjithë trafiku i regjistruar në switch-at e rrjetit qendror është regjistruar në CDR dhe ky trafik është transferuar në sistemet e faturimit. Testet tona për këto krahasime ndërmjet raporteve nga të dhënat e marra në Rrjetin Qendror, në DWH⁴ (Data Warehouse) për trafikun Zë (Voice) dhe në sistemin e faturimit 'SYMPHONY' për Internet (Data), tregojnë se ka pasur diferenca të konsiderueshme.

Sipas zyrtarëve të kompanisë, nuk është ndërmarrë një iniciativë e tillë për shkak të kompleksitetit dhe në mungesë të një sistemi të sofistikuar kërkohet që të bëhet punë e madhe në mënyrë manuale.

Rreziku Mungesa e krahasimit të të dhënave në mes të sistemeve shkakton dyshime se i gjithë trafiku i shpenzuar ka defekte në faturim dhe kjo situatë i shkakton humbje Kompanisë.

Rekomandimi A18 Kryesuesi i Bordit të sigurojë se është ndërtuar një mekanizëm i tillë për të bërë krahasimet ndërmjet trafikut të regjistruar në SWITCH-at e rrjetit qendror dhe në sistemet e faturimit në mënyrë që të sigurohet se i gjithë trafiku është duke u regjistruar në CDR dhe ky trafik është duke u transferuar në sistemet e faturimit.

³ SWITCH-at koordinojnë kanalet e komunikimit në mes të shfrytëzuesit dhe shërbimit që ata kërkojnë (thirrje, SMS, internet)

⁴ Bazë e madhe e të dhënave të grumbulluara nga një gamë e gjerë burimesh brenda një kompanie.

Çështja A19 Mangësi në parandalimin e humbjeve të të hyrave financiare dhe korigjimeve të aktiviteve që konsiderohen si jo normale

Gjetja

Telekomi i Kosovës duhet të zvogëloj dhe të parandaloj aktivitet jonormale që ndikojnë në humbjen e të hyrave financiare dhe në cilësinë e shërbimeve të ofruara. Po ashtu, sipas Marrëveshjes për mbështetje ndërmjet PTK SH.A dhe Dardafon.net LL.C, konkretisht sipas nenit 9.4 Konkurenca ilegale, parashihet që: “Palët do të kooperojnë të luftojnë dukurinë e njohur si ‘SIM to SIM’. Për më tepër, Dardafon.net është në dijeni se nëse PTK detekton ndonjë aktivitet të dukurisë SIM to SIM, PTK rezervon të drejtën të bëjë shkyçjen e këtyre numrave. Nëse kjo dukuri rezulton si ‘neglizhencë’ nga ana e Dardafon.net-it atëherë PTK rezervon të drejtën e ndërprerjes së Kontratës në tërësi sipas nenit 13.1”.

Gjatë auditimit, kemi identifikuar mangësi në parandalimin e humbjeve dhe korigjimeve të aktiviteve që konsiderohen si mashtrime. Trafiku i anashkaluar apo aktiviteti ilegal ‘Sim to Sim’ ka filluar të raportohet nga Telekomi prej muajit Qershor 2018. Është vërejtur që ky aktivitet ka pasur trend rritës muajve të fundit të vitit 2018, dhe kjo rritje ka vazhduar edhe gjatë vitit 2019, ku në tremujorin e parë të vitit 2019 ka arrit mesatarisht në 200 aktivitete të tilla në muaj. Nga rastet e identifikuar, 90% e numrave që kanë kryer aktivitete “Sim to Sim” i përkasin operatorit MVNO⁵(Z-Mobile).

Për më tepër, nga numrat e identifikuar që kanë kryer aktivitete “Sim to Sim” e që i takojnë operatorit MVNO, rreth 7% e tyre nuk janë bllokuar me kohë gjë që iu ka mundësuar që këtë aktivitet ta përsërisin. Ky aktivitet ilegal i numrave të njëjtë ka pas trend të rritjes gjatë tremujorit të parë të vitit 2019.

Pas trajtimit të kësaj çështje nga ana jonë gjatë kohës së kryerjes së auditimit, dhe njoftimit të zyrtarëve përgjegjës të këtyre aktiviteve ilegale, zyrtarët e Telekomit kanë marr qasjet në sistemin e operatorit MVNO për bllokimin e tyre.

Pavarësisht se kontrata ndërmjet “PTK-se dhe Dardafon.net (MVNO)” i obligon të dyja palët që të bashkëpunojnë në luftimin e dukurisë ‘Sim to Sim’, veprimet e të dyja palëve për trajtimin e çështjeve të raportuara lidhur me këtë dukuri kanë qenë të mangëta.

Shkak për rritjen e numrit të incidenteve të këtij lloji sipas zyrtarëve të Telekomit është ndërrimi i prefiksit nga +377 në +383, mungesa e sistemeve për identifikimin e menjëhershëm të këtyre aktiviteve si dhe mungesa e qasjes në sistemin e operatorit MVNO për bllokimin e këtyre numrave. Mos bllokimi i menjëhershëm i këtyre numrave ka ndikuar në përsëritjen e kësaj dukurie nga numrat e njëjtë.

Rreziku

Aktiviteti ilegal ‘Sim to Sim’ apo trafiku i anashkaluar ndikon në humbjen e të hyrave financiare të Kompanisë e gjithashtu edhe në cilësinë e shërbimeve.

Rekomandimi A19

Kryesuesi i Bordit të sigurojë që janë marr masat e nevojshme për identifikimin dhe bllokimin e menjëhershëm të aktiviteve që shkaktojnë humbje të të hyrave financiare e gjithashtu dëmtim të cilësisë së shërbimit.

Çështja A20 Në sistemin e kontabilitetit nuk mund të kontrollohen/ raportohen me kohë pagesat e faturave PostPaid nga pikat e shitjes.

Gjetja Të gjitha transaksionet financiare duhet të regjistrohen dhe të raportohen me kohë në sistemin e kontabilitetit, si dhe të jenë në harmoni të plotë me të dhënat që ekzistojnë nëpër sistemet tjera që Kompania i posedon.

Analizat e bëra për transaksionet e realizuara në pikat shitëse tregojnë që ka raste ku pagesat e faturave PostPaid janë raportuar me vonesë nga operatorët e shitjes (mjetet janë deponuar në bankë pas disa jave). Pagesat e faturave PostPaid dhe shitja e produkteve bëhen nëpërmjet sistemit të menaxhimit të klientëve CRM, por ky sistem nuk dërgon të dhëna në mënyrë automatike për këto pagesa në sistemin e kontabilitetit ERP. Po ashtu, nëpërmjet sistemit të kontabilitetit ERP, nuk është e mundur të identifikohen këto pagesa në momentin e realizimit të tyre.

Për më tepër, mjete e arkëtuara në pikat shitëse nuk janë të identifikueshme në sistemin e kontabilitetit ERP sipas klientëve, si dhe sistemi i kontabilitetit nuk ka mundësi të raportoj me kohë për arkëtimet e faturave PostPaid.

Si rezultat i mos komunikimit automatik ndërmjet sistemeve për pagesat e faturave PostPaid, operatorët e pikave shitëse kanë mundësi që të mos dorëzojnë mjetet për këto pagesa në baza të rregullta ditore, por për periudha të ndryshme të deponojnë mjetet për pagesat e grumbulluara.

Rreziku Mos identifikimi i pagesave të faturave të konsumatorëve në pikat shitëse nga sistemi i kontabilitetit, rrezikon që të mos ketë përputhje të të hyrave të inkasuara në sistemin e faturimit me ato të regjistruara në sistemin e kontabilitetit. Mos identifikimi i pagesave vështirëson kontrollin e të hyrave financiare nga pikat shitëse të Kompanisë.

Rekomandimi A20 Kryesuesi i Bordit të sigurojë që është bërë ndërlidhja ndërmjet sistemeve CRM dhe ERP në mënyrë që të dhënat për transaksionet e pagesave të faturave 'PostPaid' në pikat shitëse të raportohen në baza ditore.

⁵ MVNO- Mobile Virtual Network Operator - është ofrues i shërbimeve të komunikimit mobil që nuk zotëron infrastrukturën e rrjetit për ofrimin e shërbimit për klientët e tij. Një MVNO hyn në një marrëveshje biznesi me një operator të rrjetit celular për të marrë qasje në shërbimet e rrjetit me çmime me shumicë.

Çështja A21 Mos harmonizim i të dhënave për llogaritë e konsumatorëve ndërmjet sistemeve të Kompanisë

Gjetja Të dhënat e paraqitura në sistemin e kontabilitetit duhet të jenë në harmoni të plotë me të dhënat që ekzistojnë nëpër sistemet tjera të Kompanisë.

Gjatë analizës së bazës së të dhënave të marra nga sistemet për llogaritë/numrat e konsumatorëve të TK-së është vërejtur që ekzistojnë llogari/numra të konsumatorëve në këto sisteme të cilët nuk janë të harmonizuara. Pra, ka konsumatorë të cilët janë me statusin aktiv në sistemin e rrjetit qendror dhe në sistemin e menaxhimit të klientëve CRM dhe në sistemin e faturimit janë me status pasiv. Po ashtu, ekzistojnë konsumatorë të cilët janë pasiv në sistemin e faturimit dhe në sistemin CRM ndërsa në sistemin e rrjetit qendror këta konsumatorë janë aktiv.

Mos harmonizimi i të dhënave të llogarive/numrave të konsumatorëve në mes të sistemeve krijon hapsirë që konsumatorët ta marrin shërbimin dhe të mos faturohen për shërbimin e marrë.

Kjo ka ndodhë për shkak që në sistemet e rrjetit qendror të shërbimeve fikse, në rastet kur ndryshohen shënimet e regjistruara, këto ndryshime nuk aplikohen edhe në sistemet tjera. Disa nga sistemet që janë në përdorim, kanë të skaduar periudhat e mirëmbajtjes dhe përkrahjes nga operatorët ekonomik.

Rreziku Mos unifikimi i të dhënave të konsumatorëve në sisteme, e vështirëson harmonizimin e të dhënave të konsumatorëve në sisteme si dhe pamundëson trajtimin e gabimeve që shfaqen gjatë harmonizimit të të dhënave për konsumatorët. Më tutje, kjo ndikon që të ketë një pasqyrë jo të qartë të të dhënave për konsumatorët si dhe të ketë humbje të të hyrave financiare.

Rekomandimi A21 Kryesuesi i Bordit të sigurojë që të dhënat nëpër sisteme të jenë të unifikuara dhe të harmonizuara. Gjithashtu në vazhdimësi të monitorohen dhe të trajtohen kontrollet e gabimeve që shfaqen gjatë harmonizimit të të dhënave për konsumatorë.

Çështja A22 Mosfeksionimi i alarmeve në sistemin e alarmeve që bëjnë të mundur monitorimin, parandalimin dhe raportimin e incidenteve të ndryshme.

Gjetja Kompania duhet të vendosë mekanizma që incidentet e sigurisë së informacionit të monitorohen, parandalohen dhe raportohen sa më shpejt që të jetë e mundur.

Gjatë ekzaminimeve të bëra në një rast është vërejtur që kishte incidente të sigurisë së informacionit të cilat janë identifikuar me vonesë nga Kompania dhe për pasojë ka shkaktuar dëm financiar te konsumatori, e gjithashtu ky dëm është përcjell edhe tek Kompania.

Po ashtu, kishte alarme që nuk janë funksionale të cilat do të parandalonin keqpërdorimet e mundshme qoftë aksidentale apo të qëllimshme.

Për më tepër, edhe përkundër incidenteve të ndodhura Kompania nuk ka marrë masa që në të ardhmen të parandalohen incidentet e tilla në mënyrë që të minimizoj dëmet e saj e gjithashtu edhe të konsumatorit.

Sipas zyrtarëve të Kompanisë kjo ka ndodhë nga mungesa e qasjeve në sistem për konfigurim të alarmeve specifike si dhe kostove shtesë që kërkohen nga kontraktuesi i sistemit Ai.Froud, e që për pasojë këto alarme nuk janë funksionale.

Rreziku Identifikimi me vonesë i incidenteve, pamundësia e konfigurimeve të alarmeve dhe mosfeksionimi i tyre mund të ndikoj në humbjen e të hyrave financiare e gjithashtu edhe në humbjen konsumatorëve që i posedon Kompania.

Rekomandimi A22 Kryesuesi i Bordit të sigurojë që alarmet e sigurisë të jenë funksionale dhe të ndërmarrë masa adekuate për identifikimin e shpejt dhe parandalimin e incidenteve, në mënyrë që të ruhet besimi i konsumatorëve dhe minimizohen humbjet e mundshme financiare.

5.2 Kontrollat e aplikacioneve për përputhshmëri me rregulloret

Kontrollet e përputhshmërisë në sistemet e informacionit bëhen për t'u siguruar që kompania në sistemet e veta ka zbatuar rregullat e vlefshmërisë në pajtim me rregulloret.

Nga vlerësimet tona në aspektin e zbatimit të rregullave të vlefshmërisë në pajtim me rregulloret, kemi vërejtur mangësitë si në vijim:

Çështja A23 Aktivizimi i shërbimit pa qenë të regjistruar më parë si konsumator

Gjetja Sipas Rregullores për Regjistrimin e Parapaguesve të Telefonisë Mobile (ARKEP), ofruesit e shërbimeve duhet ti regjistrojnë të gjithë konsumatorët para se të aktivizohet shërbimi, pavarësisht a janë konsumator me kontratë apo parapagues, si dhe nuk duhet ti aktivizojnë numrat pa qenë të regjistruar më parë si konsumatorë.

Analizat tona të të dhënave të sistemit CRM⁶ tregojnë se për rreth 3810 SIM⁷ kartela aktive mungojnë të dhënat për konsumatorët. Këtyre numrave iu është aktivizuar shërbimi pa qenë të regjistruar më parë si konsumatorë.

Për shkak që sistemi i CRM-së lejon aktivizimin e shërbimeve pa u regjistruar konsumatorët paraprakisht, kompania nuk ka marrë masa që kjo të parandalohet, e gjithë kjo në mungesë të një mekanizmi të vlefshmërisë për aktivizimin e shërbimit.

Për më tepër, ky sistem nuk e ka të validuar fushën e numrit identifikues për parapaguesin, kështu që mjafton të vendoset një karakter në fushën për ID dhe të vazhdohet në hapat e tjerë për të aktivizuar numrin.

Rreziku Moszbatimi i rregullave të vlefshmërisë vështirëson identifikimin e konsumatorëve që kanë në shfrytëzim shërbimet e operatorit.

Rekomandimi A23 Kryesuesi i Bordit të sigurojë që në sistemin e CRM-së fushat e obligueshme të identifikimit për regjistrimin e konsumatorëve të funksionalizohen, në mënyrë që të pamundësohet aktivizimi i shërbimit pa u regjistruar konsumatori.

⁶ CRM- Customer Relationship Management është sistem për menaxhimin e të gjitha marrëdhënieve dhe ndërveprimeve të kompanisë me klientë.

⁷ ⁷ SIM (Subscriber Identity Module) Kartele - ID unike për një telefon, e cila vendoset brenda aparatit telefonik, dhe përmban informata personale për parapaguesit përfshirë edhe aktivizimin në rrjet si dhe shënimet e numrave telefonik të parapaguesve.

Çështja A24 Sistemi lejon regjistrimin e më shumë se dhjetë SIM kartelave për një konsumatorë

Gjetja Rregullorja për Regjistrimin e Parapaguesve të Telefonisë Mobile parasheh që, ofruesit e shërbimeve nuk mund të regjistrojnë në emër të një personi fizik si konsumator më tepër se dhjetë SIM kartela.

Analizat tona të të dhënave në bazën e sistemit CRM, tregojnë që ka konsumatorë, persona fizik të cilët kanë të regjistruar për shfrytëzim më shumë se dhjetë SIM kartela.

Për shkak që sistemi CRM nuk ka një mekanizëm i cili do të identifikonte numrin në posedim të SIM kartelave për ta njoftuar operatorin e shitjes me rastin e regjistrimit të personit ka ardhur deri te pamundësia e përcjelljes së tyre.

Rreziku Në mungesë të zbatimit të rregullave të vlefshmërisë në pajtim me aktet rregullative ekziston rreziku që konsumatorët që kanë në shfrytëzim shërbimet e operatorit t'i keqpërdorin ato.

Rekomandimi A24 Kryesuesi i Bordit të sigurojë që në sistemin CRM janë zhvilluar mekanizmat që kontrollojnë dhe kufizojnë regjistrimin e më shumë se dhjetë SIM kartelave për të gjithë konsumatorët fizik në mënyrë që të parandalohen keqpërdorimet e mundshme.

Çështja A25 Sistemi i CRM-së lejon identifikimin e numrit të thirrur për telefoninë fikse

Gjetja Sipas ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike, fshehtësia e komunikimit dhe e të dhënave të trafikut të një rrjeti publik komunikues dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike, duhet të mbrohen nga ofruesi i shërbimit.

Gjatë vëzhgimit fizik në sistemin e CRM-së është vërejtur që në aplikacion kur kërkohen transaksionet e konsumatorit për telefoni fikse, numrat thirrës nuk shfaqen të plotë, pra përmbajnë fshehtësi në komunikim, mirëpo kur këto transaksione eksportohen në formatin Excel atëherë numri thirrës paraqitet i plotë.

Sipas zyrtarëve sistemi CRM fillimisht është zhvilluar vetëm për telefoninë mobile, dhe me bashkimin e VALA dhe Telekomit në këtë sistem janë integruar edhe shërbimet e telefonisë fikse, e që pas integritimit nuk janë bërë kontrollet e nevojshme për identifikimin e tyre.

Rreziku Mos aplikimi i fshehjes së komunikimeve të konsumatorëve mundëson ekspozimin e privatësisë së konsumatorit nga përdoruesit e sistemit, respektivisht palët e paautorizuara.

Rekomandimi A25 Kryesuesi i Bordit të sigurojë që në sistemin CRM për telefoninë fikse, në modulën e transaksioneve të konsumatorit, janë aplikuar rregullat e fshehtësisë së konsumatorit për numrat thirrës.

5.3 Kontrollet e qasjeve logjike në sisteme

Kontrollet logjike bëhen për të siguruar integritetin e informacionit të ruajtur në sistemet informative, konfidencialitetin e të dhënave të ndjeshme dhe për të siguruar disponueshmërinë e vazhdueshme të sistemeve të informacionit.

Ekzaminimet tona në kontrollet e qasjeve logjike në sisteme, kanë rezultuar me gjetjet në vijim:

Çështja C1 Mungesë e monitorimit të regjistrave të aktiviteteve të përdoruesve në sistemet e informacionit

Gjetja Duhet të ekzistojnë kontrollet për të siguruar që gjurmët e auditimit gjenerohen, mirëmbahen për të gjitha të dhënat e transaksioneve. Gjurmët e auditimit rishikohen dhe monitorohen periodikisht për të identifikuar aktivitetet jonormale.

Testimet tona tregojnë se ekzistojnë gjurmë të aktiviteteve të përdoruesve në sistemet e audituara, mirëpo nuk ka monitorim për to. Gjurmët monitorohen vetëm me kërkesa të veçanta nga sektori i Sigurimit të të hyrave mirëpo as këto nuk monitorohen në periudha të rregullta kohore. Kompania nuk i monitoron aktivitetet e përdoruesve të jashtëm të kontraktuar për mirëmbajtje si dhe përdoruesve të cilët kanë qasje të plotë si në aplikacion po ashtu edhe në bazën e të dhënave.

Për më tepër, Kompania nuk kishte autorizuar asnjë personel që të bëjë monitorimin e këtyre gjurmëve. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave ka bërë përpjekje për monitorimin e tyre si dhe për caktimin e një zyrtari për Siguri të Informacionit, mirëpo deri më tani nuk është funksionalizuar kjo kërkesë.

Kjo ka ndodhë si pasojë e mungesës së procedurave për monitorim të rregullt të gjurmëve të auditimit. Sipas zyrtarëve të Kompanisë, kjo ka ndodhë edhe për shkak të volumit shumë të madh të të dhënave si dhe në mungesë të një sistemi për Analizë të Ngjarjeve të Ndodhura, kontrolli bëhet vetëm me inicim të rasteve të veçanta.

Rreziku Mungesa e rregullt e monitorimit të gjurmëve ndikon në mungesë të identifikimit të aktiviteteve jonormale të cilat mund të kenë efekt financiar dhe ekspozim të informacionit të paautorizuar.

Rekomandimi C1 Kryesuesi i Bordit të sigurojë që janë hartuar politika dhe procedura për monitorim të rregullt të regjistrave të gjurmëve të auditimit dhe për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e tyre nga ndryshimet. Po ashtu, të sigurojë që regjistrat e gjurmëve të auditimit mbi aktivitetet e përdoruesve rishikohen dhe të raportohen në periudha të rregullta kohore.

Çështja C2 Mangësi në kontrollet e përdoruesve me qasje të plotë në sistemet informative

Gjetja

Për të siguruar integritetin e informacionit të ruajtur në sistemet informative, konfidencialitetin e të dhënave të ndjeshme dhe për të siguruar disponueshmërinë e vazhdueshme të sistemeve të tyre të informacionit duhet të ketë kontrolle logjike.

Pas analizës së listave të përdoruesve me rolet dhe përgjegjësitë që kanë në sistemet informative, kemi vërejtur se ka përdorues me qasje të plotë si në aplikacion ashtu edhe në bazën e të dhënave. Po ashtu, qasje të plotë kanë edhe përdoruesit e jashtëm të kontraktuar për mirëmbajtjen e sistemeve.

Me rastin e vëzhgimit fizik, kemi vërejtur që administratorët e sistemeve përdorin llogari gjenerale (built-in) për tu kyçur në sisteme. Po ashtu, kemi vërejtur që ndryshimet e transaksioneve në bazën e të dhënave janë bërë me llogari/ID të administratorit, gjë që vështirëson identifikimin e aktiviteteve të bëra nga shfrytëzuesit (administratorët), pasi që këto llogari mund të përdoren nga më shumë se një shfrytëzues.

Në “data warehouse (DWH)”, baza e të dhënave që përmban të dhëna historike të cilat nuk duhet të ndryshohen, është vërejtur se ka përdorues që kanë qasje të plotë. Po ashtu, gjatë vëzhgimit fizik të DWH, përdoruesit janë kyçur në këtë platformë me llogari/ID gjenerale përmes të cilës mundësohet kontroll i pakufizuar në të gjitha bazat e të dhënave, përdoruesit e DB dhe autorizimet në SQL Server.

Kjo ka ndodhë për shkak se nuk ka procedura për menaxhimin, autorizimin dhe kontrollimin e aktiviteteve të përdoruesve me qasje të plotë në sistemet informative. Gjithashtu, punonjësit janë të ngarkuar me detyra të dyfishta, për administrimin e sistemit dhe bazës së të dhënave, role këto që rekomandohet të jenë të ndara.

Rreziku

Mungesa e kontrollit të përdoruesve me qasje të plotë në një sistem ku do të duhej të ruhej me kujdes integriteti i të dhënave, si dhe përdorimi i llogarive/ID gjeneralë (built-in) ose me qasje të pakufizuara, rrezikon që të realizohen/fshihen transaksione të qëllimshme dhe të paautorizuara dhe këto transaksione mund të mos identifikohen. Përdorimi i këtyre llogarive ekspozon tërë bazën e të dhënave ndaj rreziqeve të qëllimshme apo aksidentale.

Rekomandimi C2

Kryesuesi i Bordit të sigurojë që: janë hartuar politikat dhe procedurat për menaxhimin, autorizimin dhe kontrollimin logjik të përdoruesve me qasje të plotë; janë rishikuar aktivitetet e këtyre përdoruesve për tu siguruar që nuk kanë kryer funksione/aktivitete të paautorizuara; ndryshimet në transaksione në bazat e të dhënave po bëhen me llogari të personalizuar të administratorëve, për të parë nga kush është bërë ndryshimi; dhe të sigurojë që përdoruesit në DWH të kenë kufizime vetëm për leximin e të dhënave me qëllim të ruajtjes së integritetit të tyre.

Çështja A26 Mos ndërprerja e të drejtave dhe qasjes në sistemet informative për punonjësit apo kontraktuesit e jashtëm në momentin e ndërprerjes së kontratës apo ndryshimit të pozitës së punës.

Gjetja Të drejtat e qasjes në përdorimin e sistemeve informative për të gjithë punonjësit, kontraktuesit apo palët e treta, ndërpriten në momentin e ndërprerjes së kontratës, pasivizohen nëse nuk përdoren për një periudhë të caktuar kohore, apo përshtaten me ndryshimet e përgjegjësive.

Pas analizës së bërë listës së punonjësve të cilët kanë ndërprerë kontratën e punës me Kompaninë dhe listës së përdoruesve aktiv në sistemet që ka në shfrytëzim Kompania, kemi vërejtur që ka llogari të punonjësve që janë aktiv në sisteme.

Për më tepër, ekzistojnë llogari aktive të kontraktorëve të jashtëm që nuk u janë ndërprerë qasjet edhe pse u ka skaduar kontrata për mirëmbajtje. Po ashtu, pas analizës së qasjes së lejuar përmes VPN kemi vërejtur që disa llogari të kontraktorëve të jashtëm për mirëmbajtje, kanë ende qasje në VPN, për platformën e sistemit të faturimit “Symphony”.

Procedurat Standarde të Operimit (PSO) të Kompanisë kanë të definuar procesin e menaxhimit të user-ave në platformat ‘prepaid’ dhe ‘postpaid’ që për deaktivizimin e userit mbetet valid emaili i pranuar nga menaxheri i BSS/IT. Mirëpo, gjatë intervistave, administratorët e këtyre sistemeve kanë deklaruar që nuk kanë pranuar kërkesa për ndërprerjen e qasjes së përdoruesve. Gjithashtu, departamenti i Burimeve Njerëzore nuk i informon për ndryshimin e pozitës së punës apo për ndërprerjen e kontratës së punonjësve.

Rreziku Përdoruesit të cilët janë aktiv dhe të cilët nuk kanë kontratë pune me Kompaninë, kanë ndryshuar pozitën apo iu ka skaduar kontrata e mirëmbajtjes së sistemeve, rrezikojnë që të bëjnë aktiviteteve të qëllimshme të paautorizuara të cilat ndikojnë në funksionimin e sistemeve, zbulimin e informacionit, humbje financiare si dhe humbje të reputacionit të Kompanisë.

Rekomandimi A26 Kryesuesi i Bordit të sigurojë që janë hartuar procedurat për Menaxhimin e komunikimit për ndërprerjen e qasjeve të përdoruesve në sistemet e Kompanisë, ndërmjet administratorëve të sistemeve, menaxherëve si dhe departamentit të Burimeve Njerëzore. Po ashtu, të sigurojë që janë identifikuar dhe janë bërë pasive të gjitha llogaritë që nuk i plotësojnë kushtet të jenë aktive, në mënyrë që të parandalohen keqpërdorimet e mundshme.

Çështja C3 Mos rishikimi periodik i të drejtave të qasjes së përdoruesve

Gjetja Kompania kryen një rishikim periodik të llogarive të përdoruesve duke përfshirë një rishikim të të drejtave të qasjes së përdoruesve për të siguruar që ato mbeten të përshtatshme për funksionin e tyre.

Kompania nuk kishte procedura për rishikimin periodik të të drejtave të qasjes të përdoruesve në sisteme si dhe nuk ka kryer rishikime periodike të të drejtave të qasjes të përdoruesve. Në analizën e listës të përdoruesve në sisteme është vërejtur që ka përdorues që nuk janë kyçur në sistem më shumë se gjashtë muaj, ku disa nga këta punonjës të cilët kanë aktive llogarinë e qasjes, kanë ndërprerë kontratën me Kompaninë dhe disa kanë ndërruar funksionin zyrtar (pozitën e punës), për të cilët nuk kërkohet të kenë qasje në sisteme.

Në mungesë të procedurave për rishikim periodik të të drejtave të përdoruesve nuk është marrë iniciativë për të rishikuar të drejtat e qasjes së përdoruesve.

Rreziku Mungesa e rishikimit në baza periodike të të drejtave të qasjes së përdoruesve rrezikon që përdoruesit të kenë të drejta joadekuate me përgjegjësitë e tyre, apo që përdorues me qasje të paautorizuara të vazhdojnë të jenë aktiv në sisteme, pasi që nuk janë bërë kërkesat për ndërprerjen ose ndryshimin e qasjeve sipas përgjegjësiave të tyre.

Rekomandimi C3 Kryesuesi i Bordit të sigurojë që janë hartuar procedurat për rishikimin e të drejtave të qasjes si dhe po bëhet rishikim në baza të rregullta periodike i roleve dhe përgjegjësiave të përdoruesve për t'u siguruar që ato janë të vlefshme dhe të përshtatshme për funksionin e punës së përdoruesve.

Çështja A27 Sistemet CRM dhe SDM/HLR nuk ofrojnë siguri të mjaftueshme në autentifikim të llogarive/ID të përdoruesve

Gjetja Kompania duhet të ketë një politikë që përcakton rregulla për menaxhimin e fjalëkalimeve. Fjalëkalimet duhet të kenë së paku tetë karaktere, të jenë kombinim i tre shkronjave, numrave apo karaktereve speciale. Sistemi duhet të zbatohet ndryshimin e rregullt të fjalëkalimit dhe mos të lejojë të përdoret i njëjti fjalëkalim së paku një vit pasi që është ndryshuar.

Kemi vërejtur që sistemet CRM (ka rreth 1800 përdorues aktiv) dhe SDM⁸/HLR (sistem që shfrytëzohet edhe nga MVNO -Z - Mobile) nuk ofrojnë siguri në autentifikimin e llogarive. Këto sisteme lejojnë që përdoruesit për llogaritë/ID e tyre të përdorin fjalëkalim me gjatësi edhe me vetëm një karakter. Gjithashtu, këto sisteme nuk kanë funksion që detyron shfrytëzuesit të ndërrojnë fjalëkalimet në periudha të rregullta.

Në mungesë të politikave për menaxhimin e fjalëkalimit të llogarive të përdoruesve për sisteme, nuk janë identifikuar mangësitë e sistemeve për gjatësinë e fjalëkalimit për llogari/ID të përdoruesve dhe nuk janë testuar asnjëherë nga administruesit e sistemit si dhe nuk janë zbatuar funksionet për ndryshimin e fjalëkalimit në periudha të rregullta.

Rreziku Mungesa e kompleksitetit të fjalëkalimit si dhe mos-zbatimi i ndryshimit të fjalëkalimit në periudha të rregullta kohore rrezikon që fjalëkalimi i llogarive/ID të përdoruesve të zbulohet nga persona të paautorizuar dhe këto llogari të keqpërdoren.

Rekomandimi A27 Kryesuesi i Bordit të sigurojë që janë hartuar politika për menaxhimin e fjalëkalimit për përdorues duke përfshirë gjatësinë, kompleksitetin dhe periudhat kohore për ndryshim si dhe të sigurojë se po zbatohen këto kritere në sistemet informative.

⁸ SDM (Subscriber Data Management) – Sistem për menaxhimin e shërbimeve të konsumatorëve lokal.

6 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit (Letër Menaxhmenti i lëshuar nga firma audituese BDO) për PFV-të e vitit 2017 të NP Telekomit i Kosovës ka rezultuar me 13 rekomandime. Kompania kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, nëntë (9) nuk ishin zbatuar dhe katër (4) prej tyre janë rekomandime të pazbatuara por të mbyllura⁹. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Politikat dhe procedurat Kontabël	<p>Çështja: POLITIKAT DHE PROCEDURAT E KONTABILITETIT</p> <p>Ne rekomandojmë që Kompania të kodifikoj politikat dhe procedurat kontabël në një Manual të Politikave dhe Procedurave Kontabël. Manuali duhet të përfshijë politikat dhe procedurat tjera për të gjitha supozimet dhe vlerësimet e rëndësishme kontabël që ndikojnë në vlerat e raportuara të aseteve, detyrimeve dhe shpalosjeve të aseteve si dhe detyrimeve kontingjente në datën e pasqyrave financiare dhe në vlerat e raportuara të të hyrave dhe shpenzimeve gjatë periudhës raportuese.</p>	<p>Është formuar një komision dhe është dhënë një afat për periudhën shtator-dhjetor 2018 mirëpo nuk ka hapa konkret deri me tani. Kemi diskutuar me personat përgjegjës në TK lidhur me politikat kontabël, të njëjtit janë përgjigjur që ende nuk e kanë përgatitur këtë rregullore (Politikat Kontabël) por janë duke punuar në këtë drejtim.</p>	<p>Rekomandimi i pazbatuar Ref, Rekomandimi B1</p>

⁹ Rekomandime të mbyllura i kemi konsideruar ato rekomandime të cilat në situatën aktuale të TK nuk janë të rëndësishme për tu trajtuar.

2	Prona, Impiantet dhe Pajisjet	<p>Çështja: HUMBJA NË VLERË E PRONËS, IMPIANTEVE DHE PAJISJEVENe rekomandojmë Menaxhmentin e Kompanisë të mbajë evidencë të mjaftueshme dhe të duhur në lidhje me testimin e humbjeve në vlerë të asetëve të saj. Kurdo që vlera bartëse e një aseti tejkalon vlerën e rikuperueshme, duhet të njihet në të ardhura një humbje nga humbjet në vlerë. Vlera e rikuperueshme është më e larta e çmimit neto të shitjes dhe vlerës në përdorim të një aseti. Çmimi neto i shitjes është vlera që mund të fitohet nga shitja e një aseti në një transaksion duarshlirë përderisa vlera në përdorim është vlera e tanishme e rrjedhës së vlerësuar të parasë së pritshme në të ardhmen që rrjedh nga përdorimi i vazhdueshëm i një aseti dhe nga shitja e tij në fund të jetës së tij të dobishme.</p> <p>Për qëllime të vlerësimit të humbjes në vlerë, asetet janë grumbulluar në nivelet më të ulëta për të cilat ekzistojnë rrjedha të parasë të identifikuar ndaras (njësitë e gjenerimit të parasë). Asetet jo-financiare që kanë pësuar humbje në vlerë rishikohen për ndryshim të mundshëm të humbjes në vlerë në secilën datë raportuese.</p>	<p>Nuk ka afat të përcaktuar nga TK për zbatim të këtij rekomandimi. Kemi diskutuar me personat përgjegjës në TK lidhur me humbjet në vlerë të pronës, impianteve dhe pajisjeve dhe sipas tyre është parapare që të angazhohet konsulentë, por është anuluar aktiviteti i prokurimit. Gjatë vitit 2018 nuk pritet ndonjë progres, sepse nuk janë ndarë mjete financiare në Biznes Planin 2018.</p>	<p>Rekomandimi pa zbatuar Ref, rekomandimi B2</p>
3	Asetet e paprekshme	<p>Çështja: HUMBJA NË VLERË E ASETËVE TË PAPREKSHME</p>	<p>Nuk ka afat të përcaktuar nga TK për zbatim të këtij rekomandimi. Kemi diskutuar me personat përgjegjës në TK lidhur me humbjet në vlerë të pasurive të paprekshme dhe sipas tyre është parapare që të angazhohet konsulentë, por është anuluar aktiviteti i prokurimit. Gjatë vitit 2018 nuk pritet ndonjë progres, sepse nuk janë ndarë mjete financiare në BP2018.</p>	<p>Rekomandimi pa zbatuar Ref, rekomandimi B2</p>

		<p>Ne rekomandojmë Menaxhmentin e Kompanisë që të kryej testim të humbjes në vlerë lidhur me të paprekshmet ku vjetërsia teknike dhe teknologjike mund të jetë e rëndësishme, p.sh. shuma bartëse e një aseti mund të mos jetë e rikuperueshme. Ne rekomandojmë menaxhmentin e Kompanisë të kryej humbje në vlerë kurdo që ngjarjet ose ndryshimet në rrethana tregojnë që vlera bartëse e një aseti mund të mos jetë e rikuperueshme. Kurdo që vlera bartëse e një aseti tejkalon vlerën e saj të rikuperueshme, në të ardhura duhet të njihet një humbje nga humbja në vlerë. Vlera e rikuperueshme është më e larta e çmimit neto të shitjes dhe vlerës në përdorim të një aseti. Çmimi neto i shitjes është vlera që mund të fitohet nga shitja e një aseti në një transaksion duarshlirë përderisa vlera në përdorim është vlera e tanishme e rrjedhës së vlerësuar të parasë e pritshme në të ardhmen që rrjedh nga përdorimi i vazhdueshëm i një aseti dhe nga shitja e tij në fund të jetës së tij të dobishme.</p> <p>Për qëllime të vlerësimit të humbjes në vlerë, asetet janë grumbulluar në nivelet më të ulëta për të cilat ekzistojnë rrjedha të parasë të identifikuar ndaras (njësitë e gjenerimit të parasë). Asetet jo-financiare që kanë pësuar humbje në vlerë rishikohen për ndryshim të mundshëm të humbjes në vlerë në secilën datë raportuese.</p>		
4	Stoqet qarkulluese	Çështja: CIKLI I STOKUT ME QARKULLIM TË NGADALSHËM DHE STOKU I VJETËRSUAR	Sipas zyrtarëve përgjegjës të TK-së, stoqet me qarkullimin e ngadalshëm, janë kryesisht stoqe që përdoren për mirëmbajtje të rrjeteve (p.sh kabllot e bakrit) për të cilët është e vështirë të bëhet një qarkullim më i planifikuar	Rekomandim i pa zbatuar, mirëpo për shkak të rëndësisë e e

		<p>Artikujt e identifikuar me qarkullim të ngadalshëm ose si të vjetërsuar do të duhej të ndaheshin dhe largohen me përpikëri. Kjo do të ndihmojë në reduktimin e niveleve të stokut dhe të përmirësojë dukjen e depos. Gjithashtu mund të rrisë produktivitetin e personelit të depos dhe të eliminojë mallin me afat të skaduar për shitje. Për më tej, stoqet e tepërta reduktojnë kapitalin punues, përderisa heqja e këtyre artikujve do të gjeneroj para dhe zbritje të taksave. Prandaj, stoku duhet të analizohet tërësisht, së paku në baza tremujore, duke vlerësuar çdo artikull kundrejt përdorimit të pritshëm në të ardhmen në përcaktimin e shumës së "vërtetë" të tepërt.</p> <p>Të dhënat e strukturës së vjetërsisë së stokut në sistemin e vazhdueshëm të stokut mund të ndihmojnë për të përcaktuar se cilat produkte kanë qarkullim të ngadalshëm dhe anasjelltas cilat kanë qarkullim të shpejtë dhe kërkojnë kuantitet më të lartë në posedim. Ky informacion mund të përmirësojë në mënyrë të shprehur menaxhimin e stokut dhe të përmirësojë vendimet në blerje. Sistemi i futjes së urdhëresave të shitjes do të duhej të ishte i integruar me sistemin e vazhdueshëm të stokut për të pasur datat e fundit të shitjes përmes numrit të artikullit për një strukturë të vjetërsisë së stokut.</p>	<p>për shkak se përdorimi i tyre varët kryesisht prej prishjeve apo dëmtimeve në rrjeta që mund të ndodhin. Ndërsa, sa i përket stokut të vjetërsuar (të papërdorshëm), është realizuar një procedurë për shitjen e tyre përmes shpalljes-ankandit gjatë vitit 2016, sipas procedurave të parapara me LPP. Ndërsa gjatë vitit 2017 në mungesë të vendimit të BtD nuk është mundur të inicohet ndonjë procedurë për shitjen e tyre përmes shpalljes publike-ankandit.</p> <p>Më tej sipas zyrtarëve të TK-së, gjatë vitit 2019, me vendim e BtD besojmë se mundë të procedojm me shpallje publike të ankandit dhe do të lirohemi nga një sasi e konsiderueshme stokut të vjetërsuar (të papërdorshëm), ndërsa për stoqet me qarkullim të ngadalshëm do të bëhet një rivlerësim i tyre dhe do të ndërmerrem masat adekuate konform nevojave të kompanisë.</p>	<p>vlerësoj më si rekomandim i mbyllur</p>
5	<p>Klientet e Post-Paid (Arkëtimi i Borxheve)</p>	<p>Çështja: MOS PËRMBUSHJA E PROCEDURAVE PËR SHKYÇJEN E KLIENTËVE TË POST-PAID</p> <p>Ne rekomandojmë Menaxhmentin që të përforcoj operimin efektiv të sistemit të kontrollës dhe të respektoj procedurat e aprovuara lidhur me menaxhimin e kontratave me klientë Post-paid.</p>	<p>Nuk ka afat të përcaktuar nga TK për zbatim të këtij rekomandimi. Kemi kërkuar dëshmitë relevante nga departamenti i sigurimit të të hyrave, dhe ende nuk kemi pranuar informata dhe përgjigje.</p>	<p>Rekomandim i pa zbatuar</p>

6	Analiza e Kostove për produkte të reja	<p>Çështja: MUNGON ANALIZA E KOSTOS SË PRODUKTIT/FITIMIT NGA PRODUKTET E REJA</p> <p>Departamenti i sigurimit të të hyrave duhet të përgatisë analiza të tilla përpara dhe pas shpalljes së produkteve të reja. Këto procedura janë të domosdoshme në mënyrë që Kompania të vlerësojë mundësitë e produkteve të reja para se ato të futen në treg.</p>	Nuk ka afat të përcaktuar nga TK për zbatim të këtij rekomandimi. Kemi kërkuar dëshmitë relevante nga departamenti i sigurimit të të hyrave, dhe ende nuk kemi pranuar informata dhe përgjigje.	Rekomandimi pa zbatuar
7	Marrëveshja me Dardafon Net	<p>Çështja: MARREVESHJA ME DARDAFON NET PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS SË ARBITRAZHIT NR. 20990/MHM</p> <p>Ne rekomandojmë Menaxhmentit të kompanisë të bëjë analiza të mjaftueshme lidhur me humbjet që i shkakton kjo kontratë duke marrë parasysh humbjen e tregut aktual dhe atë potencial, vlerën e shërbimeve aktuale dhe potencial që ofrohen pa ndonjë kompensim Dardafon Net L.L.C., efektet në çmimin e shërbimeve të ofruar, në analizë duhet të angazhohen të gjithë faktorët relevant mundësia që obligimi të financohet nga bankat komerciale dhe të mbyllet kontrata, të gjitha këto të krahasohen me vlerën e obligimit që duhet të mbyllet.</p>	Kjo marrëveshje nuk ka fuqi juridike pasi që ORMV është tërhequr nga Marrëveshjes për Ekzekutim të Vendimit të Arbitrazhit (26.04.2018)e pasuar nga vendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë që ka njohur dhe ka shpallur të ekzekutueshëm vendimin e GjNA me dt. 11.02.2019. Po ashtu vendimi i Gjykatëse së Apelit të Kosovës Ae.nr 88/2019 dt.01.04.2019 ka hedhur poshtë ankesën e TK kundrejt vendimit të GJTHP.	
8	Aplikacionet financiare në TK	<p>Çështja: MANGËSIT NË PROCESIN E RISHIKIMIT TË TË DREJTAVE TË QASJES SË PËRDORUESVE</p> <p>Ne rekomandon që TK-së të marrë në konsideratë përfshirjen e një rishikimi periodik të qasjes së përdoruesve për fushat e ndjeshme për të siguruar që të drejtat e qasjes së përdoruesit mbeten të përshtatshme; kjo gjithashtu funksionon si një kontroll lehtësues në rast se procesi i dhënies / heqjes / modifikimit të qasjes rezulton i paefektshëm.</p>	Nuk ka afat të përcaktuar nga TK për zbatim të këtij rekomandimi.	Rekomandimi pa zbatuar Ref. rekomandimi C3

		Rekomandojmë minimizimin e përdorimit të llogarive të gjenerike të përdoruesve.		
9	Shitësit me parapagim (përmes Postierëve)	<p>Çështja: KONTROLLET EKZISTUESE PËR SHITËSIT ME PARAPAGIM</p> <p>Ne rekomandojmë TK-në që të shqyrtojë kontrollet ekzistuese në lidhje me aktivitetet e shitjeve të rishitësve dhe të marrë në konsideratë zbatimin e kontrolleve adekuate shtesë nëse kërkohet.</p>	<p>Gjatë procesit të shitjeve përmes rishitësve e në veçanti shitjet e numrave përmes postierëve USSD Reseller-Posta e Kosovës, ekzistonë procedura e aprovuar "USSD Work Flow" dhe konform kësaj procedure zbatohen në mënyrë sistematike kontrollet, gjithashtu edhe nga Sigurimi i të Hyrave krahasohen raportet e mbushjeve nga CRM-ja me shumën e pagesave/deponimeve. Duke marrë në konsideratë këtë vërejtje, menaxhmenti gjatë periudhës në vazhdim do të intensifikoj zbatimin e kontrolleve adekuate shtesë, nëse kërkohet mundë të angazhohet edhe auditori i brendshëm që të bëjë.</p>	<p>Rekomandimi pa zbatuar, mirëpo Për shkak të rëndësisë e vlerësojmë si Rekomandimi mbyllur</p>
10	Sistemi i informacionit	<p>Çështja: AUDITIMIT PERIODIK TË SISTEMEVE TË PAVARURA TË INFORMACIONIT</p> <p>Ne rekomandon që TK-ja të shqyrtojë kryerjen periodike të auditimit të sistemeve të informacionit në mënyrë që të fitojë një kuptim më të mirë të dobësive të kontrollit të IT-së dhe të parandalojë dobësi të tilla të mundshme që rezultojnë në gabime në sistemet financiare ose të gjenerojë dështim të papritur.</p> <p>Përveç kësaj, rekomandohet emërimi i një zyrtari të sigurisë së informacionit.</p>	<p>Nuk ka afat të përcaktuar nga TK për zbatim të këtij rekomandimi.</p>	<p>Rekomandimi pa zbatuar por i mbyllur.</p>

11	Aktivitete përdoruesve/administratorëve në aplikacionet kryesore të biznesit	<p>Çështja: KONTROLLIMI I AKTIVITETIT TË SUPER PËRDORUESVE APO ADMINISTRATORËVE NË APLIKACIONET KRYESORE TË BIZNESIT</p> <p>Ne i rekomandojmë TK-së të marrë në konsideratë procedurat e brendshme për kontrollin e veprimtarive të super përdoruesve ose administratorëve dhe të implementoj një mjedis adekuat kontrolli. Për shembull, duhet të konsiderohet shqyrtimi periodik i regjistrave të bazës së të dhënave ose aplikacioneve duke përdorur mjete automatike.</p>	Nuk ka afat të përcaktuar nga TK për zbatim të këtij rekomandimi.	Rekomandimi pa zbatuar Ref, rekomandimi C1 dhe C2
12	Siguria e shërbimeve dhe të dhënave të kompanisë nga kërcënimet eventuale	<p>Çështja: TRAJNIMET E SIGURIS DHE NDËRGJEGJËSIMI I PUNONJËSVE TË TELEKOMIT</p> <p>Ne rekomandojmë TK-në të kryejë trajnime të brendshme ndërgjegjësuese, të dërgojë Email-a periodike paralajmëruese dhe aktivitete të tjera me qëllim informimin dhe edukimin e stafit rreth kërcënimeve apo incidenteve të mundshme të ndodhura dhe me këtë për të ulur mundësinë që kërcënimet e tilla të shkaktojnë dëme të mëdha për kompaninë.</p>	Nuk ka afat të përcaktuar nga TK për zbatim të këtij rekomandimi. Sipas zyrtareve përgjegjës në TK, ky zbatim i këtij rekomandimi nuk është zbatuar ende mirëpo është në proces	Rekomandimi pa zbatuar.
13	Siguria e shërbimeve dhe të dhënave të kompanisë nga kërcënimet eventuale	<p>Çështja: KONTROLLI I AUTOMATIZUAR I SESIONEVE TË VPN PËR FURNITORËT</p> <p>Ne rekomandojmë TK-në të marrë në konsideratë mundësinë e kufizuar të qasjes së furnizuesve në mjedisin e prodhimit sa është e mundur dhe nëse ata kanë qasje në prodhim të përdorin mjetet softuerike dhe të regjistrojnë sesione të tilla me qëllim që të kenë mundësinë për shqyrtim të mëvonshëm të veprimeve të furnitorit.</p>	Nuk ka afat të përcaktuar nga TK për zbatim të këtij rekomandimi.	Rekomandimi pa zbatuar Ref, rekomandimi C1 dhe C2

	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018
1	Baza për opinion	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një analizë e detajuar për t'i përcaktuar shkaqet të cilat kanë ndikuar në modifikim të Opinionit dhe të merren veprimet e nevojshme për përmirësimin e situatës së krijuar. Pasqyrat financiare të Kompanisë duhet të përgatiten në një bazë e cila është e përshtatshme dhe e bazuar në realitetin ekonomik të Kompanisë. Nënshkrimi i pasqyrave nga KE dhe ZKFTH, duhet të bëhet vetëm nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme para se të njëjtat t'i dorëzohen BD-së.
2	Planifikimi i buxhetit	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që plani i biznesit bazohet mbi nevojat reale të Kompanisë, realizimi i tij monitorohet në mënyrë sistematike dhe ndryshimet apo devijimet e mëdha nga plani fillestar reflektohen saktë në planin e rishikuar.
3	Politikat kontabël	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë marrë veprime konkrete për përcaktimin e politikave të qarta të vlerësimeve kontabël dhe t'i rishikoj ato për ndryshime e nevojshme.
4	Pasuritë	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë marrë vendime për kryerjen e procedurës për testim të rënies në vlerë të pasurive duke dokumentuar atë sa më qartë, në mënyrë që të prezantohet një vlerë reale e pasurive dhe të eliminohen mundësitë e keq deklarimit të shpenzimeve në pasqyra financiare.
5	Shpenzime	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që ekziston ndarje e duhur e detyrave dhe përgjegjësive në kompani duke ndërmarrë veprimet adekuate për vendosjen e kësaj pozite në mënyrë që të forcoj kontrollet dhe të parandalojë konfliktet e mundshme të interesit.
6	Shpenzime	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që janë ndërmarr masat për vendosjen e kontrolleve adekuate në kompani dhe se aprovimi i shpenzimeve bëhet nga personat përgjegjës për menaxhim më efikas dhe racional të shpenzimeve.
7	Shpenzime	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që një rishikim i brendshëm po ndërmerret për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në të gjitha rastet dhe të ushtrroj më shumë kontrolle për të siguruar se mangësitë e identifikuar janë adresuar.
8	Shpenzime	Kryesuesi i Bordit të sigurojë një planifikim të detajuar të aktiviteteve të prokurimit i cili do të shmangë në të ardhmen nevojat për ndarjen e kërkesave, si dhe do të sigurojë aplikimin e procedurave të duhura siç janë kontratat publike kornizë.
9	Shpenzime	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se është shqyrtuar mangësia e identifikuar dhe se janë marrë masat e nevojshme që të respektohen dispozitat ligjore përkatëse me rastin e angazhimeve të punonjësve të rinj.

10	Menaxhim i Personelit	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që përmes akteve të brendshme të ndërmarrjes të fuqizojë kontrollet e brendshme, të cilat do të pamundësojnë lidhjen e kontratave për punë dhe detyra specifike më gjatë se afati maksimal i lejuar me ligj
11	Menaxhim i Personelit	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që përmes akteve të brendshme të ndërmarrjes të fuqizojë kontrollet e brendshme, të cilat do të pamundësojnë që punonjësit në pozitat e njëjta paguhen me grada të ndryshme..
12	Menaxhim i Personelit	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që gradimi i stafit dhe degradimi behën në bazë të kriterëve të vendosura në rregullore/politikë e cila duhet te jetë e aprovuar në Bord.
13	Menaxhim i Personelit	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se të gjitha rregulloret dhe politikat e hartuara për burimet njerëzore janë miratuar dhe që një rishikim i brendshëm po ndërmerret për të përcaktuar pse kërkesat e statutit të ndërmarrjes, ligjit për ndërmarrjet publike, kodi i etikës dhe qeverisjes korporative për ndërmarrjet publike nuk janë adresuar deri më tani dhe të ushtrojë më shumë kontrolle për të siguruar se mangësitë e identifikuara janë adresuar.
14	Auditimi i Brendshëm	Kryesuesi i Bordit në bashkëpunim me Komitetin e Auditimit të sigurojë që është hartuar statuti i AB-së, duke përcaktuar qartë përmes këtij dokumenti formal (statutit): qëllimi, pozicioni, autoriteti dhe përgjegjësia e aktiviteteve të auditimit të brendshëm në kompani.
15	Auditimi i Brendshëm	Kryesuesi i Bordit në bashkëpunim me Komitetin e Auditimit, të sigurojë që është hartuar plani i auditimit bazuar në rrezik si dhe plani strategjik duke përfshirë objektivat, fushën, kohën dhe shpërndarjen e burimeve të angazhimit. Plani duhet të konsiderojë strategjitë e Ndërmarrjes, objektivat dhe rreziqet e lidhura me angazhimin.
16	Auditimi i Brendshëm	Kryesuesi i Bordit në bashkëpunim me Komitetin e Auditimit, të sigurojnë që janë ndërmarr hapa konkret për hartimin e politikave dhe procedurave për ushtrimin e aktiviteteve të AB-së në mënyrë që të definohen qartë detyrat dhe përgjegjësitë e kësaj njësie.
17	Qeverisje e mirë	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se është hartuar një plan i cili do të identifikoj të gjitha rreziqet e mundshme, të vlerësoj ndikimin e tyre në rast se ato ndodhin, si dhe të përcaktoj masat parandaluese dhe ato të mëvonshme si përgjigje ndaj tyre.

18	Qeverisje e mirë	Kryesuesi i Bordit të sigurojë hartimin dhe vënien në përdorim të një doracaku ku do të përcaktohen elementet kryesore të cilat janë të domosdoshme për të ndihmuar në menaxhimin e fushës së pasurisë, si dhe t'i rishikoj ato në mënyrë periodike për të qenë në hap me ndryshimet e standardeve të qeverisjes.
19	Qeverisje e mirë	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se është kryer vetëvlerësimi i performancës së Bordit në bazë të kritereve të caktuar nga ana e NJPMNP e cila duhet të përfundojë me një plan konkret në fillim të vitit fiskal për të gjitha objektivat që duhet t'i realizoj deri fund të vitit duke përfshirë edhe aktivitetet kryesore që duhet të ndërmerren për realizimin e secilit objektiv të përcaktuar të bazuar në planin e biznesit.
20	Sistemet Informativ e	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se është ndërtuar një mekanizëm i tillë për të bërë krahasimet ndërmjet trafikut të regjistruar në SWITCH-at e rrjetit qendror dhe në sistemet e faturimit për t'u siguruar së i gjithë trafiku është duke u regjistruar në CDR dhe ky trafik është duke u transferuar në sistemet e faturimit
21	Sistemet Informativ e	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që janë marr masat e nevojshme për identifikimin dhe bllokimin e menjëhershëm të aktiviteteve që shkaktojnë humbje të të hyrave financiare e gjithashtu dëmtim të cilësisë së shërbimit.
22	Sistemet Informativ e	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që është bërë ndërlidhja ndërmjet sistemeve CRM dhe ERP në mënyrë që të dhënat për transaksionet e pagesave të faturave 'PostPaid' në pikat shitëse të raportohen në baza ditore.
23	Sistemet Informativ e	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që të dhënat nëpër sisteme të janë të unifikuara dhe të harmonizuara. Gjithashtu në vazhdimësi të monitorohen dhe të trajtohen kontrollet e gabimeve që shfaqen gjatë harmonizimit të të dhënave për konsumatorë.
24	Sistemet Informativ e	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që alarmet e sigurisë të jenë funksionale dhe se janë ndërmarrë masa adekuate në identifikimin e shpejt dhe parandalimin e incidenteve, në mënyrë që të ruhet besimi i konsumatorëve dhe minimizohen humbjet e mundshme financiare.
25	Sistemet Informativ e	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që në sistemin e CRM-së fushat e obligueshme të identifikimit për regjistrimin e konsumatorëve të funksionalizohen, në mënyrë që të pamundësohet aktivizimi i shërbimit pa u regjistruar konsumatori.
26	Sistemet Informativ e	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që në sistemin CRM janë zhvilluar mekanizmat që kontrollojnë dhe kufizojnë regjistrimin e më shumë se dhjetë SIM kartelave për të gjithë konsumatorët fizik në mënyrë që të parandalohen keqpërdorimet e mundshme.
27	Sistemet Informativ e	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që në sistemin CRM për telefoninë fikse, në modulën e transaksioneve të konsumatorit, janë aplikuar rregullat e fshehtësisë së konsumatorit për numrat e thirrur.

28	Sistemet Informativ e	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që: janë hartuar politika dhe procedura për monitorim të rregullt të regjistrave të gjurmëve të auditimit, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e tyre nga ndryshimet. Po ashtu, të sigurojë që regjistrat e gjurmëve të auditimit mbi aktivitetet e përdoruesve të rishikohen dhe të raportohen në periudha të rregullta kohore.
29	Sistemet Informativ e	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që: janë hartuar politikat dhe procedurat për menaxhimin, autorizimin dhe kontrollimin logjik të përdoruesve me qasje të plotë.; janë rishikuar aktivitetet e këtyre përdoruesve për tu siguruar që nuk kanë kryer funksione/aktivitete të paautorizuara; ndryshimet në transaksione në bazat e të dhënave po bëhen me llogari të personalizuar të administratorëve, për të pa nga kush është bë ndryshimi; dhe të sigurojë që përdoruesit në DWH të kenë kufizime vetëm për leximin e të dhënave me qëllim të ruajtjes së integritetit të tyre.
30	Sistemet Informativ e	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që janë hartuar procedurat për Menaxhimin e komunikimit për ndërprerjen e qasjeve të përdoruesve në sistemet e Kompanisë, ndërmjet administratorëve të sistemeve, menaxherëve si dhe departamentit të Burimeve Njerëzore. Po ashtu, të sigurojë që janë identifikuar dhe janë bërë pasive të gjitha llogaritë që nuk i plotësojnë kushtet të jenë aktive, në mënyrë që të parandalohen keqpërdorimet e mundshme.
31	Sistemet Informativ e	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që janë hartuar procedurat për rishikimin e të drejtave të qasjes si dhe po bëhet rishikim në baza të rregullta periodike i roleve dhe përgjegjësive të përdoruesve për t'u siguruar që ato janë të vlefshme dhe të përshtatshme për funksionin e punës së përdoruesve.
32	Sistemet Informativ e	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që janë hartuar politika për menaxhimin e fjalëkalimit për përdorues duke përfshirë gjatësinë, kompleksitetin dhe periudhat kohore për ndryshim si dhe po zbatohen këto kritere në sistemet informative.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit


157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër konfirmimi



Telekomi i Kosovës Sh.A.
Dardania p.n., 10000, Prishtinë
Republika e Kosovës
www.kosovotelecom.com

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2018 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmojmë se:

- kemi pranuar draft raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e Pasqyrave Financiare të Telekomit të Kosovës, për vitin 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohemi me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit përveç çështjes A18;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzojmë një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do të ju dërgojmë të plotësuar pyetësorin për vlerësimin e subjektit të auditimit. Këtë pyetësor do të pranoni me letër përcjellëse të raportit final të auditimit.

Z. Besa Shatri-Berisha



Kryesues i Bordit të Drejtorëve, TK Sh.A.

Data: 27 qershor 2019, Prishtinë,

Shtojca III: Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit

Të gjeturat/ çështjet	Pajtohemi po/jo	Komentet e NP-së në rast të mospajtitimit	Pikëpamjet e ZKA-së
Çështja 18	Jo	<p>Duke mos pas informata, se cilat vlera në fakt janë krahasuar nga auditoret, në vazhdim janë komentet për “counterat” e prezantuar nga Departamenti i Planifikimit për trafikun e Zërit:</p> <p>BSC and RNC Traffic – përfshinë numrin e minutave të kanaleve të zëna të trafikut të Zërit (TCH), gjatë një dite, për tranqet e krijuara në mes elementeve të rrjeti “Core” dhe elementet e Radios. Këtu përfshihen minutat e kanaleve të zëna për këto raste:</p> <p>Thirrje të gjeneruara dhe të terminuara përbrenda rrjetit Vala, përfshihet edhe rezervimi i kanaleve për thirrje të pasuksesshme, e që në një fazë të realizimit të thirrjes kanali rezervohet por thirrja nuk realizohet. Përfshihet edhe rezervimi i kanalit gjatë realizimit të thirrjes (Call setup).</p> <p>Thirrje të gjeneruara në Vala dhe të terminuara jashtë Vala (Ndërkombëtare, IPKO, Fix). Përfshihet edhe rezervimi i kanaleve për thirrje të pasuksesshme për arsye të ndryshme në rrjetin jashtë Vala. Përfshihet edhe rezervimi i kanalit gjatë realizimit të thirrjes (Call setup).</p> <p>Thirrje të gjeneruara jashtë Vala (Ndërkombëtare, IPKO, FIX) dhe të terminuara në Vala. Përfshihen edhe rezervimi i kanaleve gjatë realizimit të thirrjes (Call Setup).</p>	<p>Raportet dhe vlerat të cilat janë krahasuar iu janë prezantuar edhe departamenteve nga të cilat janë marrë informatat, gjithashtu burimi i të dhënave është prezantuar edhe gjatë prezantimit të të gjeturave të gjithë pjesëmarrësve në takime si dhe emalit përfundimtar të datës 21.06.2019 me dëshmi, drejtuar zyrtarëve të TK-së .</p>

	<p>Int<->VALA - përfshinë numrin e minutave të kanaleve të zëna të trafikut të Zërit në shkuarje dhe ardhje (TCH), gjatë një dite, për tranqet e krijuara në mes elementeve të rrjeti "Core" dhe Monaco Telecom-it. Ketu përfshihen minutat e kanaleve të zëna në këto trunk për thirrje nderkombetare. Ketu përfshihen edhe koha e zenesise se kanalit gjatë realizimit të thirrjes (Call Setup), si dhe për thirrje të pasukseshme por që kanali i trafikut është rezervuar në këto trunk.</p> <p>VALA<->IPKO - - përfshinë numrin e minutave të kanaleve të zëna të trafikut të Zërit në shkuarje dhe ardhje (TCH), gjatë një dite, për tranqet e krijuara për IPKO në elementeve të rrjeti "Core". Ketu përfshihen minutat e kanaleve të zëna në këto trunk për thirrje nderkombetare. Ketu përfshihen edhe koha e zenesise se kanalit gjatë realizimit të thirrjes (Call Setup), si dhe për thirrje të pasukseshme por që kanali i trafikut është rezervuar në këto trunk.</p> <p>Si konkludim mund të themi se kounterat e prezentuar si me sipër shfrytëzohen vetëm për dimensionim të rrejtimit me qëllim të përmirësimit të kualitetit dhe jo për barazim të trafikut në nivel të CDR-ve.</p> <p>Per Trafikun DATA në parim, counter-at nuk shfrytëzohen për balancim të trafikut të CDR-ve as për DATA, sepse ketu potencialisht mund të përfshihen edhe DATA gjatë fazes së vendosjes së sesionit, që në CDR nuk i kanë."</p>	<p>Sa i përket përmbajtjes së të dhënave të prezantuara në komente janë pikërisht të njëjtat të dhëna që i kemi marrë edhe nga departamenti i DWH dhe Symphony. Dhe sipas topologjisë së Rrejtimit Vala 2G/3G/4G(LTE) të prezantuar nga TK dhe sipas dokumentit 'SE_3GPP_billing_format' (5060 WCS charging 3GPP format W5.x) të prezantuar gjithashtu nga TK-ja (dokument i punuar nga ALKATEL që përmban standardin European 'Third Generation Partnership Project' (3GPP), në sistemet e billingut si dhe në CDR janë përfshirë të gjitha të dhënat përfshirë edhe kohën e kanalit të nxënë gjatë thirrjes si dhe thirrjeve të dështuara. Të dhënat e kërkuara nga tri departamentet pra përfshijnë trafikun në total për muajt 11.2018 dhe 02.2019 dhe rrjedhimisht të dhënat e këtyre departamenteve mund të krahasohen.</p> <p>Gjithashtu komentit nuk iu është bashkëngjitur asnjë dëshmi nga TK-ja që do ta paraqet një situatë ndryshe prej asaj që është përshkruar në gjetje.</p>
--	--	--